



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council



RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council

Raporti i punës për vitin 2022

© Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

LISTA E SHKURTESAVE

KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
SKGJK	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
NJIGJ	Njësia për Inspektim Gjyqësor
GJS	Gjykata Supreme
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
GJA	Gjykata e Apelit
GJK	Gjykata Komerciale
GJ.TH	Gjykata Themelore
TIK	Teknologji Informative dhe Komunikim
KE	Komisioni Evropian

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË	6
Përmbledhje ekzekutive	6
1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN	7
1.1 Vizioni.....	7
1.2 Misioni	7
1.3 Mandati	8
1.4 Përbërja e Këshillit	9
2. AKTIVITETET E KËSHILLIT	10
2.1 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit	10
2.2 Takimet dhe vendimet e KGJK.....	10
2.3 Emërimi i kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës	11
2.4 Avancimi i gjyqtarëve.....	11
2.5 Rekrutimi i gjyqtarëve	11
2.6 Rekrutimi i bashkëpunëtorëve profesional.....	11
2.7 Rekrutimi i administratorëve të gjykatave.....	11
2.8 Vlerësimi i gjyqtarëve.....	11
2.9 Miratimi i akteve nënligjore	11
2.10 Transferimi i gjyqtarëve	11
2.11 Procedura Disiplinore e Gjyqtarëve.....	11
3. TË ARRITURAT E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS GJATË VITIT 2022	13
3.1 Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës	17
PJESA E TRETË	18
4. Komisionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës	18
4.1 Komisioni për Çështje Normative	19
4.2. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.....	20
4.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave	22
4.4 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel	23
4.5 Komisioni për Trajnime	24
4.6 Komisioni për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye	24
5. BUXHETI I KËSHILLIT GJYQËSOR	25
5.1 Buxheti, shpenzimet dhe të hyrat gjyqësore.....	25
6. ASAMBLEJA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS	31
7. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL I KËSHILLIT	32
PJESA E KATËRT	33
.....	33
8. AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT	33
8.1 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit	33

8.2 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	34
8.3 Departamenti për Çështje Ligjore	37
8.4 Departamenti për Buxhet dhe Financa.....	38
8.5 Departamenti për Teknologji Informative	39
8.6 Njësia e Auditimit të Brendshëm.....	40
8.7 Departamenti për Logjistike dhe Infrastrukturë.....	41
8.8 Departamenti i Statistikave.....	43
8.9 Departamenti i Prokurimit	44
8.10 Zyra për Përkthime	45
8.11 Zyra Qendrore për Evidencë Penale.....	46
8.12 Zyra për Integritet Evropian.....	47
8.13 Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun	48
8.14 Certifikuesi.....	49
PJESA E PESTË	50
9. PANELI PËR LIRIMI ME KUSHT	50
10. NJËSIA PËR INSPEKTIM GJYQËSOR	51
11. ZYRA PËR VLERËSIM DHE VERIFIKIM.....	52
12. SFIDAT.....	53

PJESA E PARË

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i punës për vitin 2022 paraqet dokumentin kryesor lidhur me veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), si institucion kushtetues i cili siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.

Ky raport është i ndarë në katër pjesë, ku është pasqyruar në mënyrë të përgjithësuar tërë veprimtaria e Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas organizimit dhe funksionimit të vet ligjor, duke përfshirë edhe gjykatat, gjatë vitit raportues.

Pjesa e parë e raportit përmban informata të përgjithshme për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përfshirë këtu vizionin, misionin, mandatin dhe përbërjen e tij.

Në pjesën e dytë të raportit, përshkruhen të gjitha aktivitetet dhe të arriturat e KGJK-së, si dhe performanca e gjykatave themelore me degët përkatëse të tyre dhe disiplinimi i gjyqtarëve.

Në vijim të raportit, respektivisht në pjesën e tretë të tij, përshkruhet veprimtaria e Komisioneve të KGJK-së, duke vazhduar me të dhënat kryesore lidhur me buxhetin, rekomandimet e Asamblesë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës si dhe bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Pjesa e katërt paraqet veprimtarinë e Sekretariatit të KGJK-së ndërsa në fund të raportit, gjegjësisht në pjesën e pestë, përshkruhet veprimtaria e Panelit për Lirim me Kusht dhe Njësisë për Inspektim Gjyqësor, duke përfunduar me sfidat të cilat e kanë përcjellë KGJK-në, gjatë kësaj periudhe.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mandatin e tij e ushtron në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe akteve përkatëse nënligjore. Ndërsa, me Ligjin për Gjykatat është e rregulluar organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave në Republikën e Kosovës.

1.1 Vizioni

Vizioni i Këshillit është një sistem gjyqësor që është i pavarur, i qasshëm për të gjithë, i drejtë dhe efikas në punën e tij, që jep llogari në punën e vet, që është funksional dhe që u përmbahet standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, kompetencës, profesionalizmit dhe transparencës.

1.2 Misioni

Misioni i Këshillit është të krijohet dhe të ruhet një sistem gjyqësor i pavarur, që iu ofron shërbime gjyqësore të paanshme për të gjithë pa dallim dhe që është funksional në të gjitha aspektet organizative dhe operative.



1.3 Mandati

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, mandati i KGJK-së është si vijon:

- Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave sipas ligjit;
- I propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe siguron se të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, sipas procedurave përkatëse ligjore;
- I propozon Presidentit emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, siguron se kandidati i propozuar i plotëson kriteret e përcaktuara me ligj dhe janë zhvilluar procedurat përkatëse;
- Vendos për përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit Gjykatës së Apelit, të kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe gjyqtarëve mbikëqyrës;
- Siguron zbatim dhe mbikëqyrë kriteret për praninë në gjyqësor, të cilat duhet të bëhen në pajtim me parimet e meritës, mundësive të barabarta, barazisë gjinore, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve;
- Vendos për shpalljen e konkurseve për kandidatët për pozita në gjyqësor;
- Vendos për organizimin e provimit për kandidatët për gjyqtarë sipas rregullores së miratuar nga Këshilli;
- Vendos dhe mbikëqyrë zbatimin e kriterëve për përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse dhe për plotësimin e vendeve të lira të punës, të garantuara për anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- Vendos për numrin e gjyqtarëve në secilin juridiksion;
- rekomandon themelimin e gjykatave të reja dhe degëve të gjykatave, në pajtim me Ligjin për Gjykatat;
- Bën inspektimin gjyqësor;
- Administron gjyqësorin;
- Harton dhe mbikëqyrë buxhetin për gjyqësorin;
- Vendos për avancimin, transferimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve;
- Vendos kriteret për vlerësimin e rregullt të gjyqtarëve;
- Vendos për ngarkesën me lëndë të gjykatave;
- Siguron funksionimin efikas të gjykatave;
- Vendos dhe mbikëqyrë kriteret për përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve lidhur me trajnimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe personelit tjetër gjyqësorë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë;
- Miraton Kodin e Etikës Profesionale për anëtarët e Këshillit, gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë si dhe Kodin e Etikës për stafin administrativ gjyqësor, shkelja e të cilit është bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga funksioni;

- Vendos për miratimin e skemës unike të taksave gjyqësore të zbatueshme në mbarë territorin e Republikës së Kosovës;
- Siguron menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale sipas rregullores së miratuar nga Këshilli;
- Miraton raportin vjetor mbi veprimtarinë e gjykatave dhe shpenzimet e buxhetit për gjyqësorin;
- Bashkëpunon me këshillat gjyqësore të shteteve të tjera dhe organizatat përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, me kusht që të mos ndikojë në pavarësinë e punës së tij;
- Miraton aktet nënligjore në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësive të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

1.4 Përbërja e Këshillit

KGJK sipas legjislacionit në fuqi, në përbërjen e tij ka trembëdhjetë (13) anëtarë: shtatë (7) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejt nga gjyqësori, ndërsa gjashtë (6) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i anëtarëve të Këshillit është pesë (5) vjeçar. Në fund të vitit 2022, Këshilli në përbërjen e vet kishte dhjetë (10) anëtarë, që nënkupton se, tri (3) pozita nuk janë plotësuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

PJESA E DYTË

2. AKTIVITETET E KËSHILLIT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me qëllim të përmbushjes së mandatit të vet kushtetues dhe ligjor gjatë vitit 2022 ka realizuar një sërë aktivitetesh, përmes hartimit dhe miratimit të këtyre akteve:

- Strategjia e Komunikimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022 - 2024;
- Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 - 2025 lidhur me Efikasitetin dhe Prioritizimin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor;
- Planit Strategjik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për periudhën 2023 - 2025 dhe
- Planit për Sistematizimin, Digjitalizimin dhe Automatizimin e Arkivave për Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Si aktivitete të tjera të rëndësishme në kuadër të veprimtarisë së Këshillit, përfshihen edhe:

- Themelimi i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore;
- Themelimi i Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025 dhe Planin Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 – 2024;
- Caktimi i Koordinatorit për rastet e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave;
- Emërimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimeve të Komunikimeve;
- Themelimi i grupit punues për draftimin e kërkesave funksionale për sistemin e dosjes elektronike për gjyqtar “E - file”;
- Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të veprimit lidhur me implementimin e Ligjit për Gjykatën Komerciale dhe
- Themelimi i grupit punues për hartimin e akteve normative për zbatimin e projektit audio - video incizimit.

KGJK ka dhënë kontributin e tij lidhur me Procesin e Vettingut në sistemin e drejtësisë, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, përmes adresimit të komenteve drejtuar Komisionit të Venecias, ku pas pranimit të opinionit, KGJK ka ndërmarrë veprimet e nevojshme.

2.1 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka zgjedhur tre (3) anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me ç’rast njëri prej tyre ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit të anëtarit të KGJK-së.

2.2 Takimet dhe vendimet e KGJK

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka mbajtur tridhjetë e tetë (38) takime, përfshirë këtu takimet e jashtëzakonshme dhe takimet e mbajtura në formë elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli ka nxjerrë gjithsejtë pesëqind e njëzetë e tri (523) vendime.

2.3 Emërimi i kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës

KGJK ka emëruar kryetarin e Gjykatës së Apelit, Gjykatës Komerciale, Gjykatës Themelore Gjilan dhe Prizren. Gjatë kësaj periudhe, ka emëruar gjyqtarët mbikëqyrës në degët: Rahovec, Kamenicë, Novobërdë, Leposaviq dhe Zubin Potok.

2.4 Avancimi i gjyqtarëve

Këshilli ka avancuar gjashtëmbëdhjetë (16) gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, përfshirë dy (2) në divizionin e Apelit në Mitrovicë, shtatë (7) gjyqtarë në Gjykatën Supreme, duke përfshirë dy (2) gjyqtarë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

2.5 Rekrutimi i gjyqtarëve

KGJK ka përfunduar procesin e rekrutimit të dyzetë e tetë (48) kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.

2.6 Rekrutimi i bashkëpunëtorëve profesional

KGJK ka përfunduar dy (2) procese të rekrutimit të njëqind e tridhjetë e dy (132) bashkëpunëtorëve profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, si dhe ka transferuar shtatë (7) bashkëpunëtorë profesional.

2.7 Rekrutimi i administratorëve të gjykatave

KGJK ka përfunduar procesin e rekrutimit të administratorit dhe zëvendës administratorit të Gjykatës Themelore Prishtinë dhe zëvendës administratorit të Gjykatës së Apelit.

2.8 Vlerësimi i gjyqtarëve

Këshilli ka përfunduar vlerësimin e performancës së njëqind e njëmbëdhjetë (111) gjyqtarëve.

2.9 Miratimi i akteve nënligjore

Këshilli ka miratuar njëzetë e dy (22) akte nënligjore.

2.10 Transferimi i gjyqtarëve

Këshilli ka transferuar në mënyrë të përhershme katër (4) gjyqtarë.

2.11 Procedura Disiplinore e Gjyqtarëve

Këshilli Gjyqësor ka pranuar gjithsejtë njëqind e dyzet e shtatë (147) ankesa disiplinore të ushtruara nga personat fizik dhe juridik ndaj gjyqtarëve, ankesa këto të trajtuara nga autoritetet kompetente dhe Këshilli.

Janë pranuar njëqind e gjashtëmbëdhjetë (116) vendime nga autoritetet kompetente me të cilat ankesa janë refuzuar si të pa bazuara, prej tyre:

- Pesë (5) vendime për refuzim kanë qenë në lidhje me ankesat e pranuar në fund të vitit 2021 dhe
- Njëqind e njëmbëdhjetë (111) vendime për refuzim të ankesave të pranuar gjatë vitit 2022.

KGJK ka pranuar nga autoritetet kompetente, njëzetë e katër (24) kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore, prej të cilave:

- Njëzet e dy (22) kërkesa kanë rezultuar nga ankesat e ushtruara gjatë vitit 2022 dhe

- Dy (2) kërkesa të cilat kanë rezultuar nga ankesat e ushtruara në fund të dhjetorit të vitit 2021.

Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave për fillim të hetimeve disiplinore, KGJK ka themeluar njëzet e tri (23) panele hetimore, pasi që dy (2) kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore janë bashkuar dhe është themeluar një panel hetimor për të njëjtat.

Në këtë drejtim, nga njëzet e tri (23) panele hetimore, KGJK ka pranuar pesëmbëdhjetë (15) raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura. Për një panel hetimor është suspenduar procedura disiplinore për shkak se ndaj të njëjti subjekt të hetimit është duke u zhvilluar edhe hetim penal.

Këshilli, sipas detyrës zyrtare ka shqyrtuar dhe vlerësuar çështjen e suspendimit të dy (2) gjyqtarëve në dy raste disiplinore dhe me shumicë të votave ka vendosur për suspendim deri në një vendim tjetër të Këshillit.

Këshilli, ka mbajtur njëzet e tri (23) seanca dëgjimore dhe ka shqyrtuar shtatëmbëdhjetë (17) raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura.

Në seancat e cekura më lartë, pas shqyrtimit të raporteve mbi faktet dhe provat e mbledhura, janë marrë gjithsejtë shtatëmbëdhjetë (17) vendime dhe janë shqiptuar tetëmbëdhjetë (18) masa, respektivisht dy (2) masa në të njëjtin vendim për të njëjtin subjekt, të cilat janë si në vijim:

- Shtatë (7) vendime, lirim nga përgjegjësia disiplinore;
- Dy (2) vendime, vërejtje publike me shkrim;
- Një (1) vendim, vërejtje jo publike me shkrim;
- Një (1) vendim, zvogëlim i përkohshëm i pagës për 40% për gjashtë (6) muaj dhe vërejtje publike me shkrim;
- Një (1) vendim, zvogëlim i përkohshëm i pagës në lartësi prej 40%, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj;
- Një (1) vendim, transferim i përhershëm nga Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në Prishtinë në Departamentin e Përgjithshëm të të njëjtës Gjykatë;
- Një (1) vendim, transferim i përhershëm në Divizionin e Kundërvajtjes në kuadër të Gjykatës Themelore në Pejë;
- Dy (2) vendime, zvogëlim i përkohshëm i pagës për tridhjetë (30%) në kohëzgjatje për katër (4) muaj dhe
- Një (1) vendim, hudhet poshtë raporti i panelit hetimor për shkak të parashkrimit absolut të pretendimit për shkelje disiplinore të autoritetit kompetent.

Për vendimin me të cilin është shqiptuar sanksioni disiplinor vërejtje publike me shkrim është ushtruar ankesë disiplinore në Gjykatën Supreme të Kosovës. Këtë ankesë, Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar. Ankesë është ushtruar edhe ndaj vendimit transferim i përhershëm nga Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në Prishtinë në Departamentin e Përgjithshëm të të njëjtës Gjykatë dhe është refuzuar nga Gjykata Supreme, si e pa bazuar.

Ndaj vendimit zvogëlim i përkohshëm i pagës për 40% për gjashtë (6) muaj dhe vërejtje publike me shkrim është ushtruar ankesë, por KGJK ende nuk ka pranuar vendimin e Gjykatës Supreme.

Tetë (8) panele hetimore janë ende në fazën e hetimeve disiplinore.

3. TË ARRITURAT E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS GJATË VITIT 2022

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me qëllim të implementimit brenda afateve kohore të Ligjit për Gjykatën Komerciale, ka themeluar grupin punues për hartimin e Planit të Veprimit. Këshilli ka emëruar kryetarin e kësaj gjykate dhe ka përzgjedhur:

- Gjashtë (6) gjyqtarë për Dhomat e shkallës së dytë dhe
- Nëntë (9) gjyqtarë për Dhomat e shkallës së parë.

Po ashtu, ka transferuar stafin mbështetës nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore Prishtinë në Gjykatën Komerciale dhe ka caktuar edhe ushtruesin e detyrës së Administratorit të kësaj gjykate. Këshilli ka miratuar edhe listat e lëndëve që kanë kaluar nga gjykatat themelore dhe Gjykata e Apelit në kompetencë të Gjykatës Komerciale.

KGJK miratoi Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025, lidhur me Efikasitetin dhe Prioritizimin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor. Qëllimi i këtij plani është e rritja e efikasitetit në trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve në pritje për me shumë se njëzetë e katër (24) muaj dhe rasteve të natyrës prioritare sipas ligjit, të cilat janë në procedurë gjyqësore.

Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të përkthimeve në sistem gjyqësor, Këshilli pas përfundimit me sukses të proceseve vlerësuese ka certifikuar përkthyesit dhe interpretët gjyqësorë, me ç'rast është përditësuar lista e përkthyesve gjyqësor që do të përdoret nga gjykatat, si dhe institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Po ashtu, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, KGJK ka miratuar listën e ekspertëve gjyqësor.

Në drejtim të avancimit të digjitalizimit dhe përmirësimit të shërbimeve digjitale në gjykata, aktivitetet kryesore të KGJK-së të realizuara përfshijnë:


- Ndërlidhja e Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL) me Sistemin Qendror Kombëtar të Evidencës Penale (SQKEP);
- Nënshkrimi i marrëveshjes për Projektin e audio dhe video incizimit dhe
- Nënshkrimi i marrëveshjes për Projektin për dosjen elektronike të gjyqtarëve.

KGJK ka miratuar Strategjinë e Komunikimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022 - 2024, e cila ka për synim rritjen e besimit dhe mirëkuptimit të publikut, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për reformat në gjyqësor si dhe përmirësimin e koordinimit dhe komunikimit të brendshëm.


Po ashtu, Këshilli ka miratuar Planin Strategjik të Gjyqësorit për periudhën 2023 – 2025, i cili pasqyron synimin e sistemit gjyqësor për t'u bazuar mbi sukseset e Këshillit dhe gjykatave, si dhe për t'u fokusuar në fushat që kanë nevojë për përmirësim.

Këshilli ka miratuar Planin Strategjik për Sistematizimin, Digjitalizimin dhe Automatizimin e Arkivave, i cili synon praktikatat e ngjashme të shteteve anëtare të BE-së.

Gjykatat themelore treguan performancë të mirë duke zgjidhur më shumë lëndë në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021. Në grafikun e mëposhtëm, mund të shihni efikasitetin dhe mesataren e zgjidhjes së lëndëve për muaj, krahasuar me vitin paraprak.



Gjykatat kanë vazhduar me publikimin e vendimeve gjyqësore, duke ndikuar në përmirësimin dhe ngritjen e transparencës së punës së gjyqësorit. Këtë vit, gjykatat kanë publikuar mbi 35,000 aktgjykime, duke e avancuar edhe më shumë transparencën e gjyqësorit ndaj publikut.



Këshilli, me mbështetjen e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), lansoi Mekanizmin e Ndjekjes së Lëndëve (CTM) i cili si mjet digjital lejon qasje online në të dhënat e lëndëve gjyqësore individuale. Ky mekanizëm përcjellës është i qasshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës përmes një procedure të verifikuar të vërtetimit përmes platformës eKosova.



Këshilli në mbështetje të projektit të Bashkimit Evropian “Sistemi Kombëtar Qendror i Evidencës Penale”, ka lansuar platformën online të Sistemit Qendror të Evidencës Penale, për nxjerrjen e certifikatës së gjendjes penale. Përmes këtij shërbimi të ri digjital, qytetarët kanë filluar të pajisen online me certifikatat e gjendjes penale në platformën shtetërore e-Kosova.



KGJK ka organizuar aktivitete me gjykata “Ditët e Gjyqësorit”, të cilat janë mbajtur gjatë tri (3) ditëve, me qëllim të vlerësimit të gjithmbarshëm të gjendjes aktuale të sistemit gjyqësor, përfshirë të arriturat, përmbushjen e planeve të punës, sfidat me të cilat përballlet sistemi dhe objektivat strategjike për avancimin e funksionimit të sistemit gjyqësor.



Këshilli ka trajtuar të gjitha rekomandimet nga organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe grupet tjera të interesit, të cilat kanë për synim avancimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e llogaridhënies dhe transparencës. Ky nivel i transparencës dhe bashkëpunimit e bënë gjyqësorin më llogaridhënës dhe efikas.



Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, KGJK ka caktuar zyrtarët përgjegjës të gjyqësorit për trajtimin e kërkesave që bien në kompetencën për zbatimin e këtyre akteve.



3.1 Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi i KGJK-së, në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore për përfaqësimin e Këshillit para publikut, institucioneve tjera kushtetuese dhe organizatave e partnerëve ndërkombëtar, ka zhvilluar aktivitete, ka ndërmarrë iniciativa dhe ka kordinuar procese me rëndësi në fushën e reformave në njërën anë dhe në mbrojtje e qëndrimit të KGJK-së për garantimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor në anën tjetër.

Kryesuesi ka krijuar dhe zhvilluar më tutje raportet me ambasadorë dhe përfaqësues nga ambasadat dhe organizatat partnere dhe donatorët zhvillimor të cilat e mbështesin sistemin gjyqësor, duke përfshirë Misionin e EULEX-it, Komisionin e Venecias, Zyrën e Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës, INL, USAID, OSBE, UNDP, si dhe projektet aktive si EUKOJUST, MCC, NCCR, SMIL dhe të tjera.

Po ashtu, kryesuesi ka zhvilluar më tutje kordinimin dhe ka mbajtur takime të rregullta edhe me strukturën menaxheriale të gjykatave vendore si dhe stafin mbështetës të tyre.

Me qëllim të bashkëpunimit me institucionet vendore, kryesuesi ka zhvilluar takime me: Këshillin Prokurorial të Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, Avokatin e Popullit, Policinë e Kosovës, Agjencinë kundër Korrupsion dhe institucione të tjera. Kryesuesi ka vazhduar bashkëpunimin edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë dhe Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

Kryesuesi ka udhëhequr Komitetin Drejtues të Strategjisë për Sundimin e Ligjit me të cilën është shqyrtuar draft Raporti gjashtë (6) mujor i Planit të Veprimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit. Gjithashtu, ka përfaqësuar gjyqësorin edhe në konferenca dhe punëtori ndërkombëtare të organizuara jashtë vendit.

Kryesuesi ka vazhduar bashkëpunimin me përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile, me qëllim të mbështetjes së punës dhe aktiviteteve të cilat kanë për synim avancimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e llogaridhënies dhe transparencës.

Një fushë tjetër në të cilën aktivitetet e kryesuesit kanë qenë të fokusuar kanë të bëjnë me rolin e promotorit dhe kordinuesit ndër-institucional në një numër të reformave të cilat institucionet kanë pasur kordinim të ndërsjellët sikurse iniciativa e përbashkët në mes të KGJK-së, MD-së dhe Gjykatës Supreme në tre fushat e reformave, inicimin e Kodit të Procedurës Civile, Reformimin e Drejtësisë Administrative dhe Ristrukturimin e Gjykatës Supreme.

Kryesuesi i KGJK-së ka qenë artikulues dhe mbrojtës i përpiktë i qëndrimeve të KGJK-së, në raport me iniciativat e Ministrisë për procesin e Vettingun dhe iniciativat tjera, ku ka mbrojtur qëndrimin e Këshillit karshi aspekteve kushtetuese e ligjore për pavarësinë e gjyqësorit.

PJESA E TRETË

4. KOMISIONET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Këshilli realizon mandatin e vet përmes komisioneve të përhershme dhe atyre që themelohen për një mandat të caktuar ad-hoc.

Komisionet e përhershme

Të gjitha komisionet e përhershme të cilat funksionojnë në kuadër të Këshillit, kanë rregullat e tyre të punës dhe fushë veprimtarinë e ushtrojnë në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në kuadër të Këshillit funksionojnë këto komisione të përhershme, si në vijim:

- Komisioni për Çështje Normative;
- Komisioni për Vlerësimin e Performancës Gjyqësore;
- Komisioni për Administrimin e Gjykatave;
- Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel dhe
- Komisioni për Trajnime.

Me qëllim të zbatimit të rregullores për kompensim, KGJK ka themeluar edhe Komisionin për Kompensimin e Personave të Dënuar, ose të Arrestuar pa arsye.

4.1 Komisioni për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative (KÇN) është përgjegjës për iniciimin, përgatitjen dhe hartimin e të gjitha akteve nënligjore dhe politikave të nevojshme për funksionimin e Këshillit dhe gjyqësorit.

Komisioni ka mbajtur njëqind e njëmbëdhjetë takime (111) takime dhe pesë (5) punëtori, në të cilat kanë marrë pjesë partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Të gjitha draftet kanë konsumuar fazën e konsultimit publik, në përjashtim të akteve të cilat kanë rregulluar çështjet e brendshme të Këshillit, përkatësisht, njësive të Këshillit dhe gjykatave.

KÇN, ka rekomanduar për miratim në Këshill njëzet e katër (24) akte normative, përfshirë pesëmbëdhjetë (15) rregullore prej të cilave dy (2) rregullore janë për plotësimin dhe ndryshim e rregullores, një (1) udhëzim administrativ për ndryshim dhe plotësim të udhëzimit administrativ, katër (4) udhëzues, dy (2) strategji, Katalogun e Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit dhe një (1) plotësim/ndryshim të katalogut bazë.

Rregulloret e miratuara në Këshill:

- Rregullore Nr. 01/2022 për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore;
- Rregullore Nr. 02/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.07/2019 për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor së bashku me nëntë (9) shtojca;
- Rregullore Nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor së bashku me pesë (5) shtojca;
- Rregullore Nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administrator të Gjykatave (07.06.2022), së bashku me tetë (8) shtojca;
- Rregullore Nr. 05/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr.07/2017 për Organizimin dhe Funksionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
- Rregullore Nr. 06/2022 për Organizimin dhe Funksionimin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe organogramin si shtojcë përcjellëse, i cili njëkohësisht është edhe pasqyrim i rregullores;
- Rregullore Nr. 07/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Komerciale dhe organogramin si shtojcë përcjellëse, i cili njëkohësisht është edhe pasqyrim i rregullores;
- Rregullore Nr. 08/2022 për Transferimin e Gjyqtarëve, së bashku me shtojcën e tij;
- Rregullore Nr. 09/2022 për Rekrutimin dhe Emërimin e Këshilltarit Ligjor në Gjykatën Komerciale, së bashku me katër (4) shtojca;
- Rregullore Nr. 10/2022 për Procedurën Disiplinore për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Rregullore Nr. 11/2022 për Evidencën Penale në Republikën e Kosovës, së bashku me njëmbëdhjetë (11) shtojca;
- Rregullore Nr. 12/2022 për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, së bashku me katër (4) shtojca;
- Rregullore Nr. 13/2022 për Vlerësimin e Performancës së Kryetarëve dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, së bashku me pesë (5) shtojca;

- Rregullore Nr. 14/2022 për Organizimin dhe Funksonimin e Njësisë për Inspektim Gjyqësor, dhe organogramin si shtojcë përcjellëse dhe
- Rregullore Nr. 15/2022 për të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin dhe Transferimin e Bashkëpunëtorëve Profesional, së bashku me tri (3) shtojca.

Këshilli ka miratuar:

- Udhëzim Administrativ nr.01/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara;
- Udhëzues për Hartimin dhe Konsultimin Publik të Akteve Normative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, së bashku me shtatë (7) shtojcat;
- Udhëzues Themelor i Referimit për Trupat Para-Hetuese dhe Hetuese në Kryerjen e Hetimeve në Çështjet Disiplinore Gjyqësore së bashku me tre (3) shtojca;
- Udhëzues për Procedurën e Dërgimit të Shkresave nga Gjykata, së bashku me njëzet e shtatë (27) shtojca dhe
- Udhëzues për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale, së bashku me katër (4) shtojca.

Këshilli ka miratuar:

- Strategjia e Komunikimit të Këshillit Gjyqësor 2022 -2024, së bashku me Planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë së Komunikimit të Këshillit Gjyqësor 2022 -2024;
- Plani Strategjik për përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, Efikasiteti dhe Prioritizimi i Lëndëve Brenda Sistemit Gjyqësor dhe shtojcat:
 - Shtojca I: Plani i Veprimit për Efikasitetin dhe Prioritizimin e Lëndëve Brenda Sistemit të Gjyqësor dhe
 - Shtojca II: Analiza e Statistikave Vjetore të Këshillit - 2019, 2020 dhe 2021.
- Katalogu i Pozitave dhe i Përshkrimit të Vendeve të punës për të punësuarit e Gjyqësorit dhe
- Katalogu për ndryshimin dhe plotësimin e katalogut për Pozitat dhe Përshkrimit të Vendeve të punës për të punësuarit e Gjyqësorit.

4.2. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve

Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve (KVPJ) ka kompetencë të bëjë vlerësimin e performancës së të gjithë gjyqtarëve.

Komisioni ka bërë vlerësimin e performancës së njëqind e njëmbëdhjetë (111) gjyqtarëve sipas këtyre kategorive:

- Tri (3) vlerësimet e mbetura nga viti 2021, të gjyqtarëve me mandat të përhershëm të përzgjedhur sipas metodës Random për vitin 2020, për periudhën e viteve 2017, 2018 dhe 2019;
- Dyzet e dy (42) gjyqtarë të përzgjedhur sipas metodës Random, për periudhën e viteve 2018, 2019 dhe 2020;

- Njëzet e katër (24) gjyqtarë pas përfundimit të trajnimit fillestar 12 mujor në Akademinë e Drejtësisë dhe
- Nëntë (9) vlerësime për gjyqtarë për ngritje në detyrë:
 - Dy (2) gjyqtarë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit - Divizioni në Mitrovicë;
 - Një (1) gjyqtar për pozitën e Gjyqtarit Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Mitrovicë - dega në Zubin Potok;
 - Një (1) gjyqtar për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjiilan;
 - Një (1) gjyqtar për pozitën e Gjyqtarit Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Gjiilan, dega në Kamenicë;
 - Një (1) gjyqtar për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Komerciale;
 - Dy (2) gjyqtarë për Gjykatën e Apelit dhe
 - Një (1) gjyqtar për Gjykatën Supreme.

Komisioni ka bërë vlerësimin e performancës për tridhjetë e tre (33) gjyqtarë nga tridhjetë e pesë (35), të përzgjedhur sipas metodës Random për vitin 2022, për periudhën e viteve 2019, 2020 dhe 2021. Ndërsa, për dy (2) gjyqtarë nga ky grup, vlerësimi i performancës nuk ka përfunduar për arsye të bazuara në ligj.

Në vijim, tabela me të dhënat përkatëse me kategorinë e gjyqtarëve të vlerësuar dhe me shkallët e arritura të vlerësimit:

Proceset	Numri i gjyqtarëve të vlerësuar	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Ngritje në detyrë	9				4	5
Trajnim Fillestar	24					
Random 2020/2021 dhe 2022	78			1	60	17
Gjithsejtë	111	0	0	1	64	22

Me qëllim të shkëmbimit të praktikave më të mira, Komisioni ka mbajtur takime dhe punëtori me ekspertë ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Po ashtu, KGJK ka themeluar komisionin ad hoc për vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, i cili ka përfunduar vlerësimin e performancës së tre (3) kryetarëve dhe gjashtë (6) gjyqtarëve mbikëqyrës.

4.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave

Komisioni për Administrimin e Gjykatave (KAGJ) është përgjegjës për përgatitjen dhe rekomandimin e politikave për administrimin e gjykatës, përfshirë atë të menaxhimit të rrjedhës së lëndëve, teknologjisë informative të menaxhimit të lëndëve, objekteve, qasjes së publikut, logjistikës dhe sigurisë.

KAGJ ka mbajtur katërbëdhjetë (14) takime pune të rregullta dhe dy (2) takime të jashtëzakonshme, me ç'rast ka trajtuar zhvillimin, unifikimin, arritjet, sfidat dhe ngecjet në funksionimin e gjykatave.

Komisioni në bashkëpunim me Njësinë për Inspektim Gjyqësor, ka realizuar vizita të shumta në Gjykatën e Apelit dhe gjykatat themelore, të cilat janë mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë.

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe rritjes së besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor, KAGJ ka mbajtur takime të rregullta me qytetarë të Republikës së Kosovës.

Komisioni, ka përgatitur këto akte:

- Planin për sistematizimin, digjitalizimin dhe automatizimin e arkivave për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- Raportin e bërë në bashkëpunim me USAID-in, pas vizitave në korrik 2022, së bashku me gjetjet dhe rekomandimet;
- Raportin për procedurën disiplinore të administratës gjyqësore së bashku me të gjeturat dhe rekomandime;
- Raportin për vijueshmëri në punë nga stafi i gjykatave, së bashku me të gjeturat dhe rekomandimet;
- Raportin për vlerësimin e shpërndarjes së lëndëve tek gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil;
- Udhëzimin Administrativ për ndryshimin e ftesave, fletë-kthesave dhe fletë-dërgesave për të gjitha Gjykatat në Republikën e Kosovës;
- Manualin për përkthyesit e punësuar në gjykatat e Republikës së Kosovës;
- Raportin për regjistrimin e pasurisë në vlerë më të ulët se 1000€ në gjykata;
- Formularin për raportim të kryetarëve dhe gjyqtarëve për lëndë që dalin nga strategjia për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Formularin për vërtetimin e gjendjes aktuale në gjykata për lëndë që lidhen me strategjinë për qasje në drejtësi, (pesë (5) formularë të ndryshëm) dhe
- Memorandumin shpjegues për përcaktimin e Vulës Unike Zyrtare për Certifikatat e gjendjes penale me bazë në Sistemin Qendror për Evidencë Penale.

Komisioni ka themeluar grupe punuese për hartimin e akteve nënligjore, si në vijim:

- Draft Udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore;
- Draft Udhëzimin Administrativ për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike;
- Draft Udhëzimin Administrativ për Zbatimin e Procedurës së Kompensimit të Dëmit për Personat e Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye dhe
- Draft Udhëzimin Administrativ për Standardizimin e Formave të Vendimeve Procedurale.

Komisioni është angazhuar edhe në procese tjera të KGJK-së, përfshirë procesin e çertifikimit të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor dhe procesin për emërimin e ekspertëve gjyqësor, proceset për emërimin dhe avancimin e gjyqtarëve, administratorëve dhe proceset për vlerësimin e performancës së kryetarëve, gjyqtarëve mbikëqyrës dhe administratorëve të gjykatave.

4.4 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel (KBFP) përgatitë dhe rekomandon politikat për zhvillim, rishikim dhe menaxhim të buxhetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni ka mbajtur takime dhe aktivitete të cilat hynë në kuadër të mandatit dhe fushëveprimin e komisionit, duke përfshirë:

- Shqyrtimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025;
- Shqyrtimi i kërkesës buxhetore për vitin 2023 bazuar në Qarkoren Buxhetore 2023/1 dhe
- Shqyrtimi i kërkesës buxhetore për vitin 2023 sipas Qarkores buxhetore 2023/2.

Në kuadër të takimeve të rregullta me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni ka parashtruar kërkesat buxhetore për vitin 2023, lidhur me:

- Planet, projektet dhe sfidat e Këshillit Gjyqësor;
- Projektet në zhvillim, si: SMIL, SQEP, Projekti për audio dhe video incizimin e seancave gjyqësore dhe projektet kapitale infrastrukurore;
- Kërkesat buxhetore të KGJK-së, me kufijtë e përcaktuar me Qarkoret Buxhetore 2023/1 dhe 2023/2 dhe kërkesat shtesë përtej kufijve buxhetorë dhe
- Nevojën për financimin e qëndrueshëm dhe rritjen progresive të buxhetit të KGJK-së, me qëllim të garantimit të pavarësisë së plotë të gjyqësorit.

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për “Ditët e Gjyqësorit”, Komisioni ka prezantuar rreth kërkesave buxhetore për KGJK-në, për vitin 2023, përfshirë:

- Ecurinë e miratimit të kërkesave buxhetore dhe kërkesat shtesë;
- Kërkesat buxhetore të aprovuara dhe jo të aprovuara dhe
- Sfidat për arritjen e objektivave të KGJK-së për shkak të mungesave të theksuara buxhetore.

4.5 Komisioni për Trajnime

Komisioni për Trajnime ushtron detyra dhe përgjegjësi bazuar në Rregulloren për Trajnime.

Komisioni ka monitoruar Rregulloren për Trajnime, lidhur me përmbushjen e përgjegjësive nga gjyqtarët, kryetarët e gjykatave dhe akterë të tjerë dhe ka mbajtur komunikim të rregullt me Akademinë e Drejtësisë.

Komisioni ka marrë pjesë në punëtorinë lidhur me hartimin e Programit Trajnuese të Akademisë së Drejtësisë, për vitin 2023 dhe ka zhvilluar aktivitetet për përcaktimin e standardeve lidhur me përmbajtjen edhe kohëzgjatjen e trajnimit për gjyqtarët porotë.

Me qëllim të rritjes së aftësive profesionale, Komisioni ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për t'i identifikuar nevojat trajnuese për administratën gjyqësore, si një nga objektivat kryesore të gjyqësorit gjatë vitit të ardhshëm.

Komisioni ka dhënë rekomandime për rishikimin e Doracakut për Trajnime Praktike për gjyqtarë të cilët shërbejnë në Gjykatën Komerciale.

4.6 Komisioni për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye

Departamenti për Çështje Ligjore ka përgatitur së bashku me Komisionin, të gjitha dosjet lidhur me kërkesat e palëve sa i përket Kompensimit të Dëmit për persona të dënuar ose arrestuar pa arsye.

Në linkun e mëposhtëm, gjeni raportin e detajuar lidhur me kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye:

[LINKU I RAPORTIT](#) 

5. BUXHETI I KËSHILLIT GJYQËSOR

5.1 Buxheti, shpenzimet dhe të hyrat gjyqësore

Buxheti i sistemit gjyqësor dhe programeve të tij për këtë vit ka qenë 32,183,896.00€ (me të hyra, pa donacione), për gjithsejtë 2,271 pozita prej tyre:

- Katërqind e gjashtëdhjetë e një (461) gjyqtarë dhe
- Njëmijë e tetëqind e dhjetë (1,810) pozita administrative.

Pjesëmarrja e buxhetit fillestar të KGJK-së në buxhetin e Kosovës shprehur në përqindje është 1.18%.

Ndryshimet buxhetore janar - dhjetor 2022

Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur rishikim të buxhetit përveç ndryshimeve sipas kërkesave nga KGJK dhe vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës së KGJK-së, janë transferuar 110,000.00€ nga kategoria e Shpenzimeve Kapitale në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, konkretisht nga projekti kapital “Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan, dega Viti”.

Megenëse shuma nuk ka qenë e mjaftueshme për mbulimin e obligimeve për shkak të rritjes së çmimeve sidomos të karburanteve por edhe për shërbime dhe furnizime të ndryshme për nevoja të gjykatave, është kërkuar transferi i 250,000.00€ nga kategoria e Shpenzimeve Kapitale në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, konkretisht nga projekti kapital “Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prizren” si dhe transferi i 52,000.00€ brenda kategorisë së Shpenzimeve Kapitale për projektin kapital "Renovimi i objektit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të Jugut" në projektin kapital “Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega Fushë Kosovë” shuma prej 2,000.00€, si dhe shuma prej 50,000.00€ në projektin kapital “Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të gjykatave”.

Kjo kërkesë e KGJK-së nuk është aprovuar, por janë marrë si kursime apo janë transferuar në Organizata tjera buxhetore, sipas vendimit të Qeverisë Nr.14/106, pra është zvogëluar kategoria e Shpenzimeve Kapitale për 302,000.00 € për projektet e cekura më lartë.

Sipas vendimit të Qeverisë Nr. 11/112, kategoria e Shpenzimeve Kapitale është zvogëluar për 85,000.00€, me ç'rast projekti “Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prizren” është zvogëluar për 24,000.00€ dhe projekti “Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë” është zvogëluar për 61,000.00€.

Po ashtu, sipas vendimit të Qeverisë Nr. 04/115, kategoria e Pagave dhe Shtesave është zvogëluar për 691,225.86€.

KGJK ka pranuar donacione në shumë prej 247,786.24€ dhe atë nga UNDP, GIZ dhe Qeveria Norvegjeze për mbështetje të sistemit gjyqësor.

Të hyrat e bartura nga viti 2021 janë të hyrat në kategorinë e pagave prej 4,410.00€ dhe kategorinë e subvencioneve dhe transfereve në shume prej 42,498.72€.

Buxheti final i KGJK në SIMFK me të hyra dhe donacione në fund të vitit fiskal 2022 është 31,400,365.10€.

Pjesëmarrja e buxheti final të KGJK-së pas këtyre ndryshimeve në buxhetin e Kosovës është 1.15 %.

KGJK ka bërë kërkesë për transfer të 440,000.00€ nga kategoria e shpenzimeve kapitale në kategorinë e shpenzimeve komunale, në mënyrë që të ekzekutohen pagesat brenda vitit fiskal 2022 për mbulimin e obligimeve. Këto obligime kanë qenë për shkak të rritjes së çmimeve të karburanteve si dhe shërbimeve dhe furnizimeve të ndryshme për nevoja të gjykatave, me qëllim të mosbartjes së obligimeve në vitin e ardhshëm dhe ndikimit negativ në buxhetin e vitit 2023. Kjo kërkesë nuk është aprovuar nga Qeveria.

Buxheti dhe shpenzimet 2022


Në tabelën nr. 1 është paraqitur buxheti 2022, buxheti i zotuar dhe realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike.

Tabela nr. 1

Buxheti dhe Shpenzimet e KGJK-së 2022

Kategoritë ekonomike	Buxheti 2022	Buxheti i zotuar	Buxheti zotuar %	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i shpenzuar %
Paga dhe shtesa	24,399,325.14	23,747,373.72	97.33	23,747,373.72	97.33
Mallra dhe shërbime	4,093,505.00	4,019,810.81	98.20	3,865,736.79	94.44
Shpenzime komunale	394,250.00	322,419.92	81.78	317,139.70	80.44
Subvencione dhe transfere	542,498.72	499,878.08	92.14	499,878.08	92.14
Shpenzime kapitale	1,723,000.00	1,238,872.00	71.90	971,534.18	56.39
Donacione	247,786.24	151,449.09	61.12	151,449.09	61.12
Totali	31,400,365.10	29,979,803.62	95.48	29,553,111.56	94.12

Sipas grafikonit në vijim, pasqyrohet realizimi i buxhetit të Këshillit në përqindje për secilën kategori ekonomike.



Sipas tabelës, buxheti i përgjithshëm i KGJK-së, prej prej 31,400,365.10€ në vitin 2022 është zotuar në shumën prej 29,979,803.62€, shprehur në përqindje 95.48%, ndërsa është shpenzuar 29,553,111.56€, shprehur në përqindje 94.12%.

Sipas kategorive ekonomike buxheti përgjithshëm i KGJK-së është zotuar dhe shpenzuar si në vijim:

- **Paga dhe Shtesa:** Nga shuma vjetore e buxhetit prej 24,399,325.14€ (nga kjo shumë 23,308,165.14 janë nga buxheti; 1,086,750.00€ janë nga të hyrat e vitit 2022 dhe 4,410.00 € janë nga të hyrat e bartura prej vitit 2021) janë zotuar dhe shpenzuar 23,747,373.72€, shprehur në përqindje 97.33 %;
- **Mallra dhe Shërbime:** Nga shuma vjetore e buxhetit prej 4,093,505.00€ janë zotuar 4,019,810.81€ shprehur në përqindje 98.20%, ndërsa janë shpenzuar 3,865,736.79 €, shprehur në përqindje 94.44%;
- **Shpenzimet Komunale:** Nga shuma vjetore e buxhetit prej 394,250.00 € janë zotuar 322,419.92 € shprehur në përqindje 81.78%, ndërsa janë shpenzuar 317,139.70 €, shprehur në përqindje 80.44%;
- **Subvencione dhe Transfere:** Nga shuma vjetore e buxhetit nga kjo kategori prej 542,498.72 € (nga kjo shumë 500,000.00 € janë nga të hyrat e vitit 2022 dhe 42,498.72 € janë nga të hyrat e bartura prej vitit 2021) janë zotuar dhe shpenzuar 499,878.08 € shprehur në përqindje 92.14 %.
- **Shpenzimet Kapitale:** Nga shuma vjetore e buxhetit 1,723,000.00 € janë zotuar 1,238,872.00 € shprehur në përqindje 71.90 %, ndërsa janë shpenzuar 971,534.18 €, shprehur në përqindje 56.39%;

- **Donacionet:** Nga shuma vjetore e buxhetit 247,786.24 € janë zotuar dhe shpenzuar 151,449.09 € shprehur në përqindje 61.12 %.


Në tabelën nr. 2 është paraqitur buxheti 2022, buxheti i zotuar si dhe realizimi i buxhetit sipas programeve buxhetore.

Tabela nr. 2

Buxheti dhe Shpenzimet sipas programeve buxhetore të KGJK-së 2022

Programet buxhetore të KGJK	Buxheti 2022	Buxheti i zotuar	Buxheti i zotuar %	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i shpenzuar %
Sekretariati i KGJK-së	28,850,477.82	27,572,492.19	95.57	27,163,466.84	94.15
NJIGj (ish NjShPGj)	133,944.00	130,644.39	97.54	129,660.79	96.80
Gj. Supreme dhe Dhoma e Posaçme	52,505.02	23,922.23	45.56	23,922.23	45.56
Gjykata e Apelit	49,644.00	41,285.76	83.16	41,285.76	83.16
Gj.Th.Prishtinë	678,169.26	658,995.71	97.17	646,582.39	95.34
Gj.Th.Prizren	296,200.00	282,781.67	95.47	279,474.41	94.35
Gj.Th.Gjilan	298,754.00	295,549.61	98.93	295,264.41	98.83
Gj.Th.Ferizaj	223,700.00	212,361.02	94.93	212,361.02	94.93
Gj.Th.Pejë	260,200.00	259,131.30	99.59	258,673.97	99.41
Gj.Th.Gjakovë	202,600.00	180,495.18	89.09	180,495.18	89.09
Gj.Th.Mitrovicë	354,171.00	322,144.56	90.96	321,924.56	90.90
Totali	31,400,365.10	29,979,803.62	95.48	29,553,111.56	94.12

Sipas grafikonit në vijim, pasqyrohet realizimi i buxhetit në përqindje për secilin program buxhetor të Këshillit.



Siç shihet në tabelën nr. 2 dhe grafikonin e mësipërm, sipas programeve buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është si në vijim:

Buxheti për programin e Sekretariatit të KGJK: Zotuar 95.57%, ndërsa shpenzuar 94.15 %;

Buxheti për programin e Njesisë së Inspektimit Gjyqësor: Zotuar 97.54 %, ndërsa shpenzuar 96.80%;

Buxheti për programin e Gjykatës Supreme dhe Dhomës së Posaçme: Zotuar 45.56 %, po ashu edhe shpenzuar 45.56 %;

Buxheti për programin e Gjykatës së Apelit: Zotuar 83.16%, po ashu edhe shpenzuar 83.16 %;

Buxheti për programin e Gj.Th.Prishtinë: Zotuar 97.17%, ndërsa shpenzuar 95.34 %;

Buxheti për programin e Gj.Th.Prizren: Zotuar 95.47%, ndërsa është shpenzuar 94.35 %;

Buxheti për programin e Gj.Th.Gjiilan: Është zotuar dhe shpenzuar 98.93%;

Buxheti për programin e Gj.Th.Ferizaj: Është zotuar dhe shpenzuar 94.93%;

Buxheti për programin e Gj.Th.Pejë: Zotuar 99.59%, ndërsa është shpenzuar 99.41%;

Buxheti për programin e Gj.Th.Gjakovë: Është zotuar dhe shpenzuar 89.09%;

Buxheti për programin e Gj.Th.Mitrovicë: Zotuar 90.96%, ndërsa është shpenzuar 90.90%.

Të hyrat gjyqësore

Të hyrat gjyqësore të arkëtuara nga Këshilli, gjykatat dhe DHPGJS janë gjithsej: **9,821,597.56€**.

Realizimi i të hyrave gjyqësore është 113.35% (13.35% rritje) në krahasim me parashikimin vjetor fillestar, i cili ka qenë 8,664,590.00€. Ndryshimi i projeksioneve (parashikimet) e të hyrave për vitin 2022 dhe periudhën tre vjeçare 2023-2025 nga niveli qendror, ka ndikuar edhe në sistemin gjyqësor duke rishikuar projeksionet e të hyrat nga 8,664,590.00€ në 9,377,059.00€, përqindja e realizuar është 104.74% (4.74% rritje) nga parashikimi i rishikuar vjetor prej 9,377,059.00€.

Në krahasim me vitin e kaluar kemi rritje në arkëtimin e të hyrave prej 802,458,86 ose 8.90% (9,821,597.56€ – 9,019,138.70 = 802,458,86).


Në tabelën nr. 3 janë paraqitur të hyrat gjyqësore sipas llojit, shumës dhe pjesëmarrjes në përqindje.

Tabela nr. 3

Të hyrat gjyqësore 2022 Janar – Dhjetor 2022

LLOJI	SHUMA	PJESËMARRJA
Taksat e gjykatës	3,284,099.95€	33.44%
Gjobat e trafikut	1,018,480.02€	10.37%
Gjobat e gjykatës	5,181,577.05€	52.76%
Taksë për kompensimin e viktimave të krimit	234,085.00€	2.38%
Taksë për aplikim	70,000.00€	0.71%
Taksë për licencë - shërbime profesionale	23,800.00€	0.24%
Të hyrat nga konfiskimet	9,555.54€	0.10%
Totali	9,821,597.56€	100%

Sipas grafikonit në vijim pasqyrohet pjesëmarrja e të hyrave gjyqësore në përqindje:



6. ASAMBLEJA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS

Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës (Asambleja), ka rol Këshillëdhënës për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Rekomandimet e Asamblesë:

- Monitorimi dhe regjistrimi i lëndëve të parashkuara në SMIL;
- Monitorimi në trajtimin e lëndëve të shënjestruara;
- Gjetja e mekanizmave për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe politikës ndëshkimore;
- Trajtimi i të gjeturave nga raportet vjetore të gjykatave;
- Shndrimi i pozitave të stafit teknik të gjykatave në staf profesional, duke u mbështetur në kualifikimet arsimore;
- Harmonizimi i pozitave dhe pagave të sekretareve juridike me zyrtarë ligjor I, vetëm për sekretarë juridik që kanë kualifikim ‘Jurist i diplomuar’;
- Zëvendësimi i shërbimit të sigurimit dhe pastrimit me kompani private;
- Propozimi për pensionim të parakohshëm të stafit mbështetës mbi moshën gjashtëdhjetë e tre (63) vjeçare;
- Zbatimi i Planit të Veprimit për Drejtësi Procedurale në Gj.Th. Mitrovicë dhe Gj.Th. Ferizaj;
- Rishikimi i memorandumeve të bashkëpunimit të KGJK-së me institucionet dhe organizatat tjera dhe çështja e prononcimit të gjyqtarëve për media;
- Përpunimi dhe publikimi i statistikave individuale të gjyqtarëve;
- Bashkëpunimi në mes të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave;
- Ndërmarrja e masave për mos dështimin e seancave gjyqësore dhe mbajtja e seancave pa shkëputje;
- Implementimi i Planit Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022 – 2025 lidhur me efikasitetin dhe prioritizimin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor;
- Vlerësimi i gjendjes së sigurisë dhe kushteve të punës në Pallatin e Drejtësisë;
- Barazimi dhe siguri i kualitetit të të dhënave në SMIL dhe SQEP si dhe ndërlidhja e sistemit SMIL në mes të Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore dhe
- Arkivimi i lëndëve arkivore të noterëve, pas përfundimit të mandatit.

7. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL I KËSHILLIT

Me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të ndryshme që lidhen me punën e gjyqësorit, KGJK ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Marrëveshjet e nënshkruara, janë si në vijim:

1. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Pen Strategy Consulting Group, Kosovë;
2. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil, për procedurat standarde të operimit ARC dhe KGJK;
3. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Universitetit “Haxhi Zeka” – Fakulteti Juridik;
4. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike;
5. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Shoqatave të personave me aftësi të kufizuara: Hendikos, Shoqata e të verbërve të Kosovës dhe Shoqata Kosovare e të Shurdhëve;
6. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Chemonics International Inc;
7. Marrëveshje ndërmjet KGJK-së dhe Administratës së Gjyqësorit të Norvegjisë;
8. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Avokaturës Shtetërore;
9. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Akademisë së Drejtësisë;
10. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
11. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme;
12. Memorandum ndërmjet projektit KGJK-së dhe Iniciativa për sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor: Krimi i rëndë dhe i Organizuar (WBROLI SOC);
13. Amandamenti i parë i Memorandumit të mirëkuptimit në mes të Fondacionit të Mijëvjeçarit dhe KGJK-së;
14. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Demokraci Plus (D+);
15. Marrëveshje e nivelit të shërbimit ndërmjet Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe KGJK-së;
16. Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit për shërbimin online të certifikatës së gjendjes penale;
17. Memorandum ndërmjet KGJK-së dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
18. Aneks marrëveshje për kryerjen e shërbimeve postare me Postën e Kosovës sh.a. për Gjykatën Komerciale.

PJESA E KATËRT

8. AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është organ administrativ profesional, i cili në kuadër të tij ka strukturën e vet organizative me të cilën ofron mbështetje profesionale dhe administrative Këshillit dhe gjykatave. Ky organ, përbëhet nga nëpunësit civil dhe zyrtarët e angazhuar në bazë të marrëveshjeve të veçanta të cilët përbëjnë administratën qendrore të sistemit gjyqësor.

Brenda strukturës së tij, Sekretariati ka këtë rregullim organizativ:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit;
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Departamenti për Çështje Ligjore;
- Departamenti për Buxhet dhe Financa
- Departamenti për Teknologji Informative;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm;
- Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë;
- Departamenti i Statistikës;
- Departamenti për Prokurim.
- Zyra për Përkthime;
- Zyra Qendrore për Evidencë Penale;
- Zyra për Integritet Evropian;
- Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun , dhe
- Certifikuesi.

8.1 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit

Bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit është Zyrtari Kryesor Administrativ.

Drejtori i Përgjithshëm, në kuadër të përgjegjësisë së tij, ndër të tjera ka nxjerr një mijë e njëzet e dy (1022) vendime të ndryshme dhe ka mbajtur mbi dyqind (200) takime zyrtare me institucione vendore dhe partnerë ndërkombëtarë.

Pas përfundimit të procedurave rekrutuese, drejtori ka nënshkruar pesëdhjetë e një (51) akt emërimi lidhur me konkurse të jashtme, tetëmbëdhjetë (18) akt emërimi lidhur me konkurse të brendshme dhe tetëdhjetë e shtatë (87) marrëveshje për Shërbime të Veçanta.

8.2 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për udhëheqjen, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave ligjore lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Sekretariat, NJIGJ dhe gjykata, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Me Ligjin për buxhetin e vitit 2022, janë lejuar gjithsejtë: dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e një pozita (2,271), me ç'rast janë buxheti i KGJK-së për të punësuar është rritur për nëntëdhjetë e katër (94) pozita.

Në kuadër të KGJK-së, kemi dy (2) programe buxhetore:

1. Programi buxhetor i SKGJK-së: dy mijë e dyqind e dyzet e katër (2,244) pozita dhe
2. Programi buxhetor i NJIGJ: njëzet e shtatë (27) pozita.

KGJK, ka aprovuar Planin e Personelit për vitin 2022 për: SKGJK, NJIGJ, gjykata dhe degët e tyre sipas kësaj ndarje:

- KGJK, SKGJK-së, gjykatat dhe degët e tyre: dy mijë e dyqind e dyzet e katër (2,244) pozita, prej të cilave janë paraparë katër qind e shtatëdhjetë e një (471) pozita për gjyqtarë dhe një mijë e shtatë qind e shtatë dhjetë e tre (1773) pozita për të punësuar tjerë dhe
- Programi buxhetor i NJIGJ: njëzet e shtatë (27) pozita.

Deri në fund të vitit raportues, sistemi gjyqësor ka gjithsejtë dy mijë e një qind e njëzet e një (2121) të punësuar prej të cilëve:

- Gjinia femërore: një mijë e pesë (1005) të punësuar apo 47.38% dhe
- Gjinia mashkullore: një mijë e një qind e gjashtëmbëdhjetë (1116) të punësuar apo 52.61%.
- Shqiptar: një mijë e tetë qind e tri dhjetë e gjashtë (1836) apo 86.7%;
- Serb: dy qind e katër dhjetë e tre (243) apo 11.3%;
- Boshnjak: njëzet e nëntë (29) apo 1.3% dhe
- Tjerë: trembëdhjetë (13) apo 0.7%.

Kategoritë e të punësuarve:

- **Gjyqtarë:** katër qind e njëzet e dy (422) të punësuar prej të cilëve:
 - Gjinia femërore: njëqind e dyzet e gjashtë (146) apo 34.6% dhe
 - Gjinia mashkullore: dy qind e shtatë dhjetë e gjashtë (276) apo 65.4%.
- **Niveli profesional:** një mijë e tre qind e tre (1303) të punësuar prej të cilëve:
 - Gjinia femërore: shtatë qind e nëntë dhjetë e shtatë (797) apo 61.69% dhe
 - Gjinia mashkullore: katër qind e nëntë dhjetë e pesë (495) apo 38.31%.
- **Staf teknik dhe mbështetës:** 407 të punësuar prej të cilëve:
 - Gjinia femërore: gjashtëdhjetë e dy (62) apo 15.2% dhe
 - Gjinia mashkullore: treqind e tridhjetë e pesë (345) apo 84.8%.

Në procedurë rekrutimi janë:

- Tridhjetë e shtatë (37) pozita për gjyqtarë dhe
- Katër dhjetë (40) pozita për bashkëpunëtorë profesional.

Procedurat e rekrutimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

LLOJI I POZITËS	Numri i pozitave të rekrutuara	GJINIA				NACIONALITETI								TË REKRUTUAR			
		Femra	%	Meshkuj	%	Shqiptar	%	Serb	%	Boshnjak	%	Tjerë	%	nga brenda sistemit gjyqësor	%	nga jashtë sistemit gjyqësor	%
GJYQ TAR	48	20	41.7%	28	58.3%	44	91.7%	3	6.3%	1	2.1%	0	0.0%	18	37.5%	30	62.5%
BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL	132	75	56.8%	57	43.2%	125	94.7%	6	4.5%	1	0.8%	0	0.0%	32	24.2%	100	75.8%
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I SKGJK	1	0	0.0%	1	100.0%	1	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	1	100.0%	0	0.0%
ADMINISTRATOR GJYKATE	1	0	0.0%	1	100.0%	1	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	1	100.0%	0	0.0%
ZEVENDËS ADMINISTRATOR GJYKATE	2	1	50.0%	1	50.0%	2	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	2	100.0%
ZYRTAR LIGJOR	40	26	65.0%	14	35.0%	39	97.5%	1	2.5%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	40	100.0%
ZYRTAR PËR PËRKTHIME	9	6	66.7%	3	33.3%	8	88.9%	0	0.0%	1	11.1%	0	0.0%	0	0.0%	9	100.0%
ZYRTAR I TEKNOLOGJISË INFORMATIVË	2	1	50.0%	1	50.0%	2	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	2	100.0%
ZYRTAR EKZEKUTIV	9	7	77.8%	2	22.2%	9	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	9	100.0%
TOTAL	244	136	55.7%	108	44.3%	231	94.7%	10	4.1%	3	1.2%	0	0.0%	52	21.3%	192	78.7%

Procedurat e avancimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

LLOJI I POZITËS	Numri i pozitave të Avancuar	GJINIA				NACIONALITETI							
		Femra	%	Meshkuj	%	Shqiptar	%	Serb	%	Boshnjak	%	Tjerë	%
Avancime të gjyqtarëve në Gjykatë Supreme	5	1	20.0%	4	80.0%	3	60.0%	2	40.0%	0	0.0%	0	0.0%
Avancime të gjyqtarëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme	2	0	0.0%	2	100.0%	2	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Avancime të gjyqtarëve në Gjykatë të Apelit	15	5	33.3%	10	66.7%	13	86.7%	2	13.3%	0	0.0%	0	0.0%
Avancime të gjyqtarëve në Shkallën e dytë të Gjykatës Komerciale	4	1	25.0%	3	75.0%	4	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa	4	1	25.0%	3	75.0%	3	75.0%	0	0.0%	0	0.0%	1	25.0%
Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të lëndëve	4	3	75.0%	1	25.0%	4	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika	2	1	50.0%	1	50.0%	2	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Udhëheqës i zyrës për menaxhimin e lëndëve	1	0	0.0%	1	100.0%	1	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Zyrtar Çertifikues	1	1	100.0%	0	0.0%	1	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Zyrtar të tjerë	6	2	33.3%	4	66.7%	6	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
TOTAL	44	15	34.1%	29	65.9%	39	88.6%	4	9.1%	0	0.0%	1	2.3%

Shënim: Në tabelë nuk janë përfshirë pesëdhjetë e një (51) zyrtarët e brendshëm të cilët janë avancuar përmes konkurseve të jashtme, në këto pozita:

- Tetëmbëdhjetë (18) gjyqtarë;
- Tridhjetë e dy (32) bashkëpunëtor profesional dhe
- Një (1) administrator i gjykatës.

Përfundimi i marrëdhënies së punës është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

PËRFUNDIM I MARRËDHËNIES SË PUNËS	TOTAL	Gjyqtar	%	Staf	%	GJINIA				NACIONALITETI							
						Femra	%	Meshkuj	%	Shqiptar	%	Serb	%	Boshnjak	%	Tjerë	%
Përfundim i marrëdhënies së punës me PENSIONIM	64	16	25.0%	48	75.0%	33	51.6%	31	48.4%	49	76.6%	9	14.1%	2	3.1%	4	6.3%
Përfundim i marrëdhënies së punës me DOREHEQJE	23	2	8.7%	21	91.3%	8	34.8%	15	65.2%	18	78.3%	2	8.7%	3	13.0%	0	0.0%
Përfundim i marrëdhënies së punës me SHKARKIM	1	1	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	1	100.0%	1	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Përfundim i marrëdhënies së punës me VDEKJE	6	1	16.7%	5	83.3%	2	33.3%	4	66.7%	5	83.3%	1	16.7%	0	0.0%	0	0.0%
TOTAL	94	20	21.3%	74	78.7%	43	45.7%	51	54.3%	73	77.7%	12	12.8%	5	5.3%	4	4.3%

Projekti i UNDP-së, Mbretëria Norvegjeze dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, kanë mbështetur sistemin gjyqësor me staf mbështetës si dhe KGJK ka pasur marrëveshje bashkëfinancimi me Projektin e BE-së, NCCR.

Pozitat e stafit mbështetës të angazhuar në gjykata, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

POZITA	Lloji i marreveshjes	PAGESA	Fillimi	Përfundimi	TOTAL	GJINIA			
						Femra	%	Meshkuj	%
Zyrtar për përkthime në GjTh Prishtinë	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.01.2022	30.06.2022	4	2	50.0%	2	50.0%
Zyrtar Ligo në GjTh Prishtinë	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.01.2022	31.12.2022	8	4	50.0%	4	50.0%
Zyrtar Ligo në GjTh Ferizaj	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.01.2022	31.12.2022	4	3	75.0%	1	25.0%
Konsulent/e i/e përkohshëm ligjor/e në Gjykata	Marrëveshje mes KGJK-NCCR/BE	KGJK	01.01.2022	31.12.2022	15	10	66.7%	5	33.3%
Konsulent/e i/e përkohshëm ligjor/e në Gjykata	Marrëveshje mes KGJK-NCCR/BE	NCCR / BE	01.01.2022	31.12.2022	15	10	66.7%	5	33.3%
Zyrtar ligjor në Dhomën e Posacme te GJS	Marrëveshje mes KGJK-AKP	AKP	01.09.2022	31.12.2022	10	10	100.0%	0	0.0%
Trajnere në Projektin TIK/SMIL në Gjykata	Marrëveshje mes KGJK-TIK SMIL	TIK/ SMIL	01.01.2022	31.12.2022	21	13	61.9%	8	38.1%
Zyrtar për përkthime në GjTh Prishtinë	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	17.12.2022	16.06.2023	3	1	33.3%	2	66.7%
Zyrtar Ligo në GjTh Gjakovë	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.12.2022	30.06.2023	2	2	100.0%	0	0.0%
Zyrtar Ligo në GjTh Prizren	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.12.2022	30.06.2023	2	1	50.0%	1	50.0%
Zyrtar Ligo në GjTh Gjilan	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.12.2022	30.06.2023	1	1	100.0%	0	0.0%
Zyrtar Ligo në GjTh Mitrovicë	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.12.2022	30.06.2023	1	1	100.0%	0	0.0%
Zyrtar Ligo në GjTh Pejë	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	01.12.2022	30.06.2023	1	0	0.0%	1	100.0%
TOTAL					87	58	66.7%	29	33.3%

Të dhënat lidhur me masat disiplinore të shqiptuara ndaj të punësuarve në administratën gjyqësore, janë si në vijim:

- Pezullim i marrëdhënies së punës: gjashtë (6), prej të cilëve tre (3) të pezulluar këtë vit;
- Ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vite dhe transferi në gjykatë tjetër për tre (3) muaj, një (1);
- Ndalim i 1/3 e pagës për një (1) muaj: një (1);
- Pensionim i parakohshëm si masë disiplinore: një (1) dhe
- Lirim nga përgjegjësia: një (1).

8.3 Departamenti për Çështje Ligjore

Departamenti për Çështje Ligjore, është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve juridike të Këshillit, mbështetjen e Komisioneve dhe Paneleve të përhershme dhe ad hoc të Këshillit si dhe përfaqësimin e Këshillit në konteste gjyqësore dhe procedura administrative, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Departamenti ka realizuar këto aktivitete:

- Ofrimi i udhëzimeve dhe monitorimi i shërbimeve në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore për Këshillin, komisionet dhe Komitetin Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore;
- Hartimi i draft akteve nënligjore, si në vijim:
 - Udhëzues për Hartimin dhe Konsultimin Publik të Akteve Normative të KGJK-së;
 - Draft Rregullore për Vlerësimin e Performancës të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
 - Draft Rregullore për Vlerësimin e Performancës së Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit dhe anëtarëve me orar të plotë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
 - Draft Rregullore për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
 - Draft Rregullore për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin dhe Transferimin të Bashkëpunëtorëve Profesional;
 - Draft Rregullore për Qasje në Dokumente Publike;
 - Draft Rregullore për normën e gjyqtareve;
 - Draft Rregullore për pasurin jo financiare;
 - Draft Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Asamblenë e Gjyqtarëve;
 - Rregullore për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin dhe Transferimin të Administratorëve të Gjykatave;
 - Draft Rregullore për Avancimin e Gjyqtarëve dhe
 - Draft Rregullore për Qasje në Dokumente Publike.

Departamenti ka përfaqësuar KGJK-në në një qind e katër dhjetë e katër (144) konteste të ndryshme gjyqësore.

Janë hartuar:

- Shtatëdhjetë e një (71) përgjigje në padi;
- Tridhjetë e katër (34) ankesa të ushtruara ndaj vendimeve të shkallës së parë;
- Pesë (5) revizione;
- Nëntë (9) prapësime;
- Një (1) padi;
- Dyzet e tetë (48) vendime dhe 1 (një) njoftim nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së;
- Pesëqind e njëzet e tre (523) vendime të nxjerra nga Këshilli;
- Mbi katërqind e pesëdhjetë (450) përgjigje ndaj shkresave/parashtesave të pranuar nga personat fizik dhe juridik dhe

- Mbi njëqind (100) opinione/memo shpjeguese.

Departamenti ka ofruar mbështetje ndaj komisioneve ad hoc të themeluara nga KGJK, lidhur me:

- Auditimin e ekzekutimit të dënimeve gjyqësore në lëmin penale dhe kundërvajtjes;
- Auditimin e të dhënave statistikore të punës së gjyqtarëve për periudhën 2018-2020;
- Auditimin e zbatimit të masave për mbrojtje nga pandemia Covid-19 dhe
- Përgatitjen e dosjeve lidhur me vlerësimin e performancës së ish kryesuesit të KGJK-së, ish kryetares së KÇN-së, ish gjyqtarëve mbikëqyrës dhe disa kryetarëve të gjykatave.

Departamenti i ka ofruar mbështetje Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025 dhe Planin Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 – 2024.

Gjithashtu, Departamenti ka përgatitur Raportin për Implementimin e Planit të Veprimit lidhur me Strategjinë e Sundimit të Ligjit 2022-2026 si dhe Planin e Punës së KGJK-së për vitin 2022.

8.4 Departamenti për Buxhet dhe Financa

Departamenti për Buxhet dhe Financa është përgjegjës për planifikimin, menaxhimin, ekzekutimin e shpenzimeve buxhetore dhe arkëtimin e të hyrave dhe depozitave gjyqësore për nevojat e Këshillit, njësisë të Këshillit dhe gjykatave, siç përcaktohet me legjislacionit në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Departamenti ka realizuar këto aktivitete:

- Ekzekutimi i buxhetit të KGJK-së sipas ndarjeve buxhetore dhe ndryshimeve buxhetore;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Planifikimi i buxhetit 2023-2025 sipas qarkoreve buxhetore 2023/01 dhe 2023/02;
- Përgatitja e kërkesave buxhetore 2023-2025 për Kuvendin, Qeverinë dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përgatitja përmbledhëse e kërkesave buxhetore 2023-2025 për dëgjimet buxhetore;
- Zotimi dhe shpenzimi i buxhetit për kategorin e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve si dhe shpenzimeve kapitale sipas planifikimit buxhetor;
- Regjistrimi i transaksioneve në regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit (SIMFK) si dhe mbajtja e evidencës kontabël në formatin e raportimit sintetik dhe analitik në SKGJK-së;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare për shpenzimet buxhetore dhe të hyrave gjyqësore;
- Përgatitja e raporteve mujore lidhur me obligimet e papaguara dhe obligimet kontraktuale për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përgatitja e raporteve për procesin e pajtueshmërisë së regjistrave kontabël në SIMFK dhe regjistrave kontabël të KGJK-së - barazimi mujor i të hyrave dhe shpenzimeve me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;

- Në bashkëpunim me Departamentin e Logjistikës në SKGJK është kriju aplikacionit alternativ në Excel për sistemin “E-pasuria” dhe ju është shpërndar të gjitha gjykatave për përdorim;
- Modifikimi i softuerit për Menaxhimin Elektronik për Menaxhimin e të Hyrave (SEMH);
- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare për vitin 2022;
- Monitorimi i punës së gjykatave për çështje të buxhetit dhe financave, rreth zbatimit të akteve të miratuara nga KGJK;
- Bashkëpunimi me auditorët e brendshëm dhe jashtëm si dhe monitorimi i planit të veprimit për auditimin e vitit 2021 dhe
- Monitorimi dhe përgatitja e raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

8.5 Departamenti për Teknologji Informative

Departamenti për Teknologji Informative, është përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së teknologjisë informative dhe të komunikimit elektronik për Këshill dhe gjykata, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Aktivitetet kryesore të realizuara, përfshijnë zbatimin e projekteve me rëndësi për gjyqësorin, si:

- Sistemi i Menaxhimit Informativë i Lëndëve;
- Ndërlidhja SMIL me Sistemin Qendror Kombëtar i Evidencës Penale dhe
- Projekti i audio dhe video incizimit.

Implementimi i SMIL, është zgjeruar sa i përket vënies në zbatim edhe në Gjykatën Komerciale, me ç’rast ka filluar regjistrimi i lëndëve të reja si dhe janë duke u bartur lëndët nga gjykatat tjera.

Po ashtu, në SMIL është bërë avancimi i kriterëve të shpërndarjes automatike të lëndëve për gjykatat themelore si dhe është përmbyllur Faza e Tretë (faza konsoliduese) si dhe ka filluar së zbatuari Faza e Katërt (faza tranzitore) e cila do të zgjasë tre (3) vite.

Lidhur me përdorimin e SMIL, janë ofruar trajnime dhe ri trajnime për treqind e njëzet e pesë (325) të punësuar në sistemin gjyqësor.

Me vendim të KGJK-së, janë larguar të gjithë librat manual në gjykata, duke u zëvendësuar me regjistrat elektronik në SMIL.

Gjatë këtij viti, është pilotuar funksioni i shpërndarjes automatike të lëndëve për Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit.

Zhvillimi i sistemit për dosjen e gjyqtarëve, është mbështetur nga Projekti EUKOJSUT, i cili ka kryer me sukses procedurat e prokurimit dhe ka kontraktuar një kompani për zhvillimin e sistemit të dosjes së gjyqtarëve, i cili është në fazën e definimit të kërkesave funksionale.

Sistemi pritet të funksionalizohet në vitin 2023 dhe do të përmbajë të dhënat lidhur me: dosjen e gjyqtarëve, performancën, disiplinën, trajnimin, karrieren, promovimet dhe statistika të ndryshme.

Këtë vit, bërë lansimi i dy (2) platformave: Mekanizmi për Përcjelljen e Rasteve (CTM) dhe Platforma për të Dhënat e Hapura (ODP), ku palët kanë qasje përmes portalit të KGJK-së në të dhëna për lëndët e tyre dhe raportet statistikore të gjykatave.

Me mbështetjen e projektit CEPEJ, është përgatitur drafti i Planit Strategjik për TIK për KGJK dhe gjykata.

Po ashtu, me qëllim të ngritjes së vetëdijësimit për sigurinë kibernetike, Departamenti ka mbajtur trajnime për të punësuarit në gjykata, i cili aktivitet është mbështetur nga projekti i MCC-së “Public Access to Judicial Information”.

Stafi i TI-së në KGJK dhe gjykata, janë angazhuar në zbatimin e projektit për audio-video regjistrimin e seancave gjyqësore në gjykata, i cili po mbështetet nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe e Zbatimit të Ligjit (INL).

Me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve në shërbime digjitale, Departamenti ka përgatitur funksionalizimin e realizimit të pagesave për taksa gjyqësore, i cili do të mundësohet përmes platformës e-Kosova.

Janë hartuar dhe zhvilluar në SMIL raporte të avancuara statistikore të cilat përfshijnë: numrin e lëndëve të pazgjidhura, moshën e lëndëve në pritje, kohëzgjatjen e procedurave, numrin e seancave të mbajtura për lëndë të zgjidhura dhe të dhëna të tjera. Në këto raporte janë përfshirë edhe indikatorët e CEPEJ për matjen dhe vlerësimin e gjyqtarëve dhe performancës së gjykatave.

8.6 Njësia e Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm, vepron sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe statutit të saj.

Njësia ka përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara, si më poshtë:

- Ekzekutimi i pagesave për ekspert gjyqësor, avokatë sipas detyrës zyrtare, gjyqtarë prototë dhe kthimi i depozitave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan;
- Menaxhimi i procedurave dhe shpenzimeve për blerjen e inventarit në SKGJK dhe gjykata;
- Menaxhimi i procedurave të rekrutimit dhe kontratat për shërbime të veçanta në Njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore të SKGJK-së dhe gjykata dhe
- Menaxhimi i procedurave të prokurimit në SKGJK dhe gjykata.

Njësia ka realizuar auditimin e përcjelljes për këto objektiva sipas planit:

- Auditimi i listës së pagave dhe pagesave jashtë orarit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të SKGJK-së dhe gjykatave;
- Auditimi i të hyrave gjyqësore, shpenzimeve të procedurës gjyqësore dhe të përmbarimit në Departamentin për Buxhet dhe Financa të SKGJK-së si dhe gjykata dhe
- Auditimi i shpenzimeve pa procedurë të prokurimit në Departamentin për Buxhet dhe Financa në SKGJK dhe gjykata.

Njësia ka hartuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2022-2024 dhe Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2022.

Janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Njësia ka realizuar Planin për vitin 2022 si dhe ka përcjellë zbatimin e rekomandimeve ku janë përfunduar nëntë (9) raporte të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, ka mbajtur takime me qëllim të mbikëqyrjes së planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

Pas aprovimit nga Udhëheqësi më i lartë i KGJK-së, janë dorëzuar te Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, Plani Strategjik (2023-2025) dhe Plani Vjetor i Auditimit të Brendshëm për vitin 2023.

8.7 Departamenti për Logjistike dhe Infrastrukturë

Departamenti për Logjistike dhe Infrastrukturë është përgjegjës dhe siguron që Këshilli dhe gjykatat të kenë furnizim të duhur dhe me kohe me materialet e nevojshme për funksionimin efikas dhe efektiv, përfshirë mbështetjen logjistike dhe me infrastrukture ndërtimore, automjetet e transporti, sigurinë fizike dhe administrimin e dokumenteve të arkivit në Këshill.

Departamenti ka realizuar këto aktivitete:

- Përfundimi i projekteve për ndërtimin e objekteve të gjykatave në Prizren, Drenas, Viti;
- Projektin për renovimin e objektit të ish Jugobankës për Gjykatën Themelore në Mitrovicë;
- Përgatitja e kërkesave të gjykatave për investimet kapitale që lidhen me riparimet e objekteve dhe ndërtimin e objekteve të reja;
- Mbështetja e gjykatave në përdorimin dhe futjen e të dhënave në sistemin elektronik E-pasuria;
- Mbështetja në regjistrimin e pasurisë;

- Investimet për projektet kapitale në shpronësimin e lokacionit të Gjykatës në Prizren dhe Mitrovicë të Jugut;
- Ndërtimi i objektit, furnizimi dhe montimi i Trafos Elektrike në degën e Fushë Kosovës dhe
- Përfundimi i objektit të degës Glllogvc.

Shumat e investimeve lidhur renovimin dhe mirëmbajtjen e disa objekteve të gjykatave, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës	60615.15€
Gj.Supreme	3533.88€
Gj.Apelit	8536.09€
Gj.Th.Mitrovicë, dega Vushtrri	11824.76€
Gj.Th.Mitrovicë	36926.93€
Gj.Th.Mitrovicë, dega Leposaviq	25179.95€
Gj.Th.Prishtinë	2603.87€
Gj.Th.Prizren, divizioni Kundërvajtjes	14693.47€
Gj.Th.Ferizaj, dega Kaçanik	12585.40€
Gj.Th.Pejë, dega Istog	4695.03€
Totali	181.194.10

Departamenti ka përmbushur kërkesat e gjykatave për servisim dhe furnizim me inventar, klima, pajisje teknologjike, material zyrtar, të shtypur dhe të tjera të nevojshme, përmes kontratave të prokurimit.

Zyra për Arkivë, në kuadër të këtij departamenti ka regjistruar:

- 1874 shkresa në protokollin e KGJK-së;
- 2,193 shkresa në protokollin e SKGJK-së;
- 2690 shkresa/vendime për gjykata;
- 1240 lëndë të arkivuara;
- 1,364 aplikacione për gjyqtar;
- 1,457 aplikacione për bashkëpunëtor;
- 785 fatura;
- 2.981 kërkesa për punë jashtë orarit të administratës gjyqësore dhe gjyqtarëve në kujdestari;
- 1.881 pagesa në sistemin 'Pay-roll' për Divizionin e Pagave në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;

- Është realizuar kompensimi i shtesave për anëtarët e KGJK-së dhe administratën e gjykatave, sipas legjislacionit në fuqi;
- 110 shkresa/vendime të shpërndara dhe
- 162 lëndë të regjistruara për lëndët e kompensimit të dëmit.

Këshilli ka në shfrytëzim njëqind e tridhjetë e shtatë (137) automjete, prej tyre pesëdhjetë e tre (53) vetura me qira nga kontrata me AQP-në.

Departamenti ka punuar në raportet e pranimit të rreth pesëqind (500) lëndëve, të cilat janë regjistruar në Free Balance.

8.8 Departamenti i Statistikave

Departamenti i Statistikave është përgjegjëse për të ofruar përkrahje profesionale Këshillit dhe komisioneve lidhur me çështje që kane të bëjnë me statistikat për punën në gjykata, si dhe përgatitjen e analizave krahasuese të statistikave që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor.

Departamenti i Statistikës ka përgatitur këto raporte:

- Raporti i përgjithshëm statistikor për tremujorin e I-rë 2022;
- Raporti i përgjithshëm statistikor për tremujorin e II-të dhe gjashtëmujorin e I-rë 2022;
- Raporti i përgjithshëm statistikor për tremujorin III-të dhe nëntëmujorin e vitit 2022;
- Raporti i përgjithshëm statistikor vjetor 2022;
- Dosjet për Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, me të dhënat statistikore për tridhjetë e gjashtë (36) muaj për njëqind e njëmbëdhjetë (111) gjyqtarë;
- Raporti për lëndët e vjetra të gjykatave, tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2022;
- Raportet statistikore për vepra penale që kanë të bëjnë me korrupsion, tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2022;
- Raportet e rregullta për Ministrinë e Integritetit Evropian, tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2022;
- Raportet e rregullta për Ministrinë e Punëve të Brendshme për veprën penale Trafikim me Njerëz, tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2022;
- Raportet e rregullta për Ambasadën Amerikane për veprën penale Trafikim me Njerëz, tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2022;
- Raportimi i rregullt në “Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin” për tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2021;
- Raportimi i rregullt në OSBE, për tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2022;
- Raportimi i rregullt për zyrtarët e EULEX-it, për tremujorin I, II, III dhe IV-të dhe
- Ofrimi i statistikave për gazetarë, OJQ dhe qytetarë.

8.9 Departamenti i Prokurimit

Departamenti i Prokurimit është përgjegjës për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të prokurimit për nevojat e Këshillit dhe gjykatave, në pajtueshmëri me Planin e Prokurimit dhe nevojat e identifikuar, siç përcaktohet me legjislacionit në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Departamenti ka realizuar tridhjetë e nëntë (39) kontrata publike për punë, shërbime dhe furnizime. Kontratat publike janë të ndara sipas procedurave të prokurimit publik:

- Kontrata publike me procedurë të negociuar një (1):
 - Shërbime shtesë nga kontrata bazë: Sigurimi i auto përgjegjësisë për automjetet e KGJK-së dhe gjykatave.

- Kontratat me vlerë të madhe katër (4):
 - Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të gjykatave dhe SKGJK-së;
 - Blerja e pajisjeve të TI-së për SKGJK dhe gjykata;
 - Furnizim me material të shtypur për SKGJK dhe gjykata, dhe
 - Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dega në Glllogoc.

- Kontratat publike projektim dhe mbikëqyrje katër (4):
 - Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për objektin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega Glllogoc;
 - Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për objektin e Gjykatës Themelore në Gjilan, dega Viti;
 - Punimi i projektit për renovim dhe mbikëqyrjes profesionale për objektin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe
 - Punimi i projektit kryesor për renovim dhe mbikëqyrjes profesionale për objektin e Gjykatës Themelore në Prizren.

- Kontratat me vlerë të mesme pesëmbëdhjetë (15):
 - Pastrimi i veturave të KGJK-së dhe gjykatave;
 - Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes qendrore në objekte të gjykatave dhe SKGJK;
 - Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të KGJK-së dhe gjykatave;
 - Furnizim me letër për KGJK dhe gjykata;
 - Lot 1. Furnizimi dhe montimi me klima për SKGJK dhe gjykata;
 - Lot 2. Servisimi i klimave në objektet e SKGJK dhe gjykatave;
 - Dhënia në shfrytëzim e hapësirave të KGJK-së për shërbim me pije;
 - Sigurimi fizik i personelit dhe objektit të SKGJK-së;
 - Sigurimi i auto përgjegjësisë për automjetet e KGJK-së dhe gjykatave;
 - Servisim dhe mirëmbajtje të gjeneratorëve në objekte të gjykatave dhe KGJK-së;
 - Shërbimet backup të rrjetit WAN;
 - Servisimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve në objektet e SKGJK-së dhe gjykatave;
 - Servisimi dhe mirëmbajtja e kamerave në objekte të SKGJK-së dhe gjykatave;
 - Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të TI-së;
 - Blerja dhe vendosja e trafos elektrike për objektin e Gjykatës Themelore në Prishtinë;
 - Blerja e laptopëve për SKGJK dhe gjykata;
 - Furnizim me licenca softurike dhe

- Furnizim me material higjienik për KGJK dhe gjykata.
- Kontratat me vlerë koetimit pesë (5):
 - Shërbimet e domainit, hostit dhe mirëmbajtjes të portalit gjyqësor;
 - Kontrollimi teknik për automjetet e KGJK-së dhe gjykatave;
 - Furnizim me material zyrtar për KGJK dhe gjykata;
 - Rregullimi dhe furnizimi me pajisje i sallës së takimeve në KGJK dhe
 - Furnizim me notesë dhe kimikë për zyrtarët e KGJK-së dhe gjykata.
- Kontratat me vlerë minimale gjashtë (6):
 - Rregullimi i defektit me rrymë në objektin e gjykatës në Zubin Potok;
 - Publikimi i pozitave të lira në mjetet e informimit publik;
 - Shërbimin e televizioneve kabllorike dhe internet WiFi 20 MB për KGJK-në;
 - Furnizim me material të shtypur për Gjykatën Komerciale;
 - Furnizim me pajisje të zyrës të kryetarit të Gjykatës Komerciale dhe
 - Furnizim me material zyrtar për KGJK dhe gjykata.

8.10 Zyra për Përkthime

Zyra për Përkthime është përgjegjëse për përkthimin e të gjitha materialeve që ofrohen për përkthim nga Sekretariati dhe njësitë tjera të Këshillit, përfshirë përkthimin simultan dhe konsektiv gjatë takimeve të Këshillit dhe komisioneve të tij, mirëmbajtjen e regjistriave të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor të licencuar.

Zyra ka bërë përkthimin e të gjitha materialet që ka pranuar, gjithsejtë rreth 4.941 faqe përkthim me shkrim dhe rreth 321 orë përkthim simultan dhe/ose konsektiv. Po ashtu, zyra ka shërbyer si anëtare e rrjetit dhe e bordit për shërbime gjuhësore në kuadër të Zyrës së Komisionerit për Gjuhë dhe vlen të ceket se nuk ka pranuar asnjë ankesë nga qytetarët për mos respektimin e gjuhëve zyrtare nga gjykatat e Kosovës.

Me qëllim të diskutimit të çështjeve të shërbimit të përkthimit dhe interpretimit në gjyqësor, Zyra ka realizuar vizita në të gjitha gjykatat e Kosovës.

Zyra ka hartuar Raportin Vlerësues për shërbimet e përkthimit dhe interpretimit në gjykatat e Kosovës, me mbështetjen e projektin EUKOJUST.

Zyra ka ndihmuar të gjitha gjykatat në përkthimin e materialeve si dhe identifikimin e përkthyesve të certifikuar për çifte të ndryshme gjuhësh varësisht nevojave të tyre.

Po ashtu, kjo zyrë ka mbështetur KGJK-në në organizimin e procedurave të licencimit dhe certifikimit të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë si dhe është angazhuar në komisionin ad hoc për verifikimin e dokumentacioneve të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë të certifikuar më parë me aktvendim nga ish Gjykatat e Qarkut.

Me mbështetjen e projektit EUKOJSUT, Zyra ka hartuar draft doracakun për punën e përkthyesve dhe interpretëve në sistemin gjyqësor si dhe udhëzuesin dhe kodin e etikës për përkthyesit dhe interpretët e sistemit gjyqësor. Ky doracak ka për qëllim përcaktimin e rregullave, standardeve dhe procedurave për organizimin e punës së përkthyesve dhe interpretëve brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

Zyra ka marr pjesë në tryezën e rrumbullakët “Koordinimi Ndërinstitucional i Shërbimeve të Përkthimit dhe Interpretimit” në mes të KGJK-së, KPK-së dhe Policisë së Kosovës të organizuar nga EUKOJUST, i cili ka për qëllim krijimin e një mekanizmi të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve përmes një memorandumit të bashkëpunimit.

8.11 Zyra Qendrore për Evidencë Penale

Zyra Qendrore për Evidencë Penale është përgjegjëse për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në menaxhimin e regjistrimit kombëtar të personave të dënuar.

Këtë vit, është funksionalizuar në tërësi Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Republikës së Kosovës, me ç’rast Departamenti ka ndërmarr të gjitha aktivitetet e nevojshme. KGJK ka zhvilluar procesin e ngritjes së kapaciteteve të rregullta njerëzore dhe teknike në të gjitha gjykatat themelore dhe degët e tyre përkatëse.

Zyra ka realizuar këto aktivitete:

- Ka vazhduar procesin e regjistrimit të lëndëve të reja penale në të gjitha gjykatat themelore në data bazën qendrore të SQEPRK-së dhe u proceduan mbi 25000 lëndë të reja penale;
- Finalizimi i procesit të ngritjes dhe ndërtimit të data bazës qendrore të evidencës penale, e cila është operative në të gjitha gjykatat e vendit;
- Ka hartuar draft Rregulloren mbi Evidencën Penale në Republikën e Kosovës;
- Janë finalizuar shumica e procedurave standarde të veprimit të cilat përfshijnë proceset kryesore në kuadër të operimit të sistemit;
- Ka filluar zbatimin e sistemit të ri të certifikatave të gjendjes penale, me bazë në SQEPRK, të cilat mund të tërhiqen përmes platformës shtetërore online e-Kosova dhe fizikisht në të gjitha gjykatat themelore me degët e tyre;
- Departamenti ka filluar procesin e rehabilitimit ligjor dhe fshirjes së dënimeve të cilat kanë arritur afatet e fshirjes nga evidenca e personave të dënuar;
- Ka vazhduar procesin e skanimit të të gjitha aktgjykimeve penale të formës së prerë në gjykatat e vendit;

- Ka vazhduar ofrimin e shërbimeve të gjendjes penale për institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe
- Ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet relevante shtetërore, në funksion të realizimit të mandatit të saj;

Në tabelën e mëposhtme, përfshihen disa të dhëna të përgjithësuara mbi gjendjen aktuale në data bazën e Sistemit Qendror të evidencës penale, si dhe disa informacione tjera te përgjithshme nga fushë veprimtaria e ZQEP-së).

Nr. Total i Rasteve në SQEP		32,9343
Nr. total i rasteve të regjistruara në SQEP gjatë vitit 2022		25,353
Nr. total i personave të dënuar gjatë vitit 2022		11,529
Nr. i rasteve të evidentuara në Gjykatat Themelore, së bashku me degët e tyre (lëndë të regjistruara në vitin 2022)	Gj.Th.Prishtinë	7,555
	Gj.Th.Prizren	2,777
	Gj.Th.Ferizaj	2,064
	Gj.Th.Pejë	4,733
	Gj.Th.Gjilan	3,009
	Gj.Th.Mitrovicë	3,584
	Gj.Th.Gjakovë	1,631
Nr. i certifikatave mbi dënimet penale (periudha prej kur ka filluar zbatimi i sistemit të ri të certifikatave, nga data 16.12.2022 e deri më 31.12.2022)		11,959
Shërbime të ofruara të gjendjes penale për institucione		3,205
Nr.i dënimeve të cilat janë shlyer nga evidenca e personave të dënuar (Rehabilitim ligjor)		60,421
Numri i Aktgjykimeve të Skanuara		130,087

8.12 Zyra për Integritet Evropiane

Zyra për Integritet Evropiane është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes profesionale, sigurimin e informacioneve të nevojshme dhe raportimin për sistemin gjyqësor, hartimin e strategjive, planeve dhe aktiviteteve në lidhje me procesin e integriteteve evropiane.

Zyra ka mbështetur Këshillin në përcaktimin dhe monitorimin e objektivave dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me procesin e integritetit në Bashkimin Evropian. Po ashtu, ka raportuar në baza të rregullta lidhur me zbatimin e përmbushjes së obligimeve të gjyqësorit të parapara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Raportimet janë bërë për të gjitha programet që KGJK është e përfshirë, respektivisht Inputet për Raportin e Vendit, Agjenda për Reforma Evropiane (ERA), Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), Programi për Reformë në Ekonomi (PRE), Komiteti i Stabilizim Asociimit, Nën-komiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri (DLS), dhe Nën komiteti për Ekonomi, Çështje Financiare dhe Statistika. Gjithashtu, janë ofruar raportime edhe për kërkesa ad hoc të Zyrës së BE-së në Kosovë, Zyrës së Kryeministrit, Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve tjera.

Zyra ka mbështetur organizimin e Misionit vlerësues TAIEX të Komisionit Evropian mbi rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe ka bashkëpunuar me të gjitha projektet që mbështesin sistemin gjyqësor. Po ashtu, ka ofruar mbështetje profesionale dhe administrative në grupe punuese, në komisione të ndryshme të Sekretariatit dhe aktivitete tjera të Këshillit.

8.13 Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun

Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun ka siguruar në vazhdimësi transparencë dhe qasje publike për punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke ofruar informata të nevojshme dhe qasje në dokumentet publike me kërkesë të qytetarëve, mediave dhe Organizatave Joqeveritare (OJQ).

Me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve me median dhe publikun, për një komunikim sa më efikas dhe sa më transparent në sistemin gjyqësor, janë caktuar zyrtarët për qasje në dokumente publike për të siguruar informacion të saktë për median dhe publikun, në funksion të përmirësimit të transparencës, si hap i rëndësishëm për kthimin e besimit të publikut.

Ueb faqja e gjyqësorit është funksionale, me informacione të përditësuara për aktivitetet e KGJK-së, me ç'rast është punuar që ueb faqja t'i përshtatet përdoruesve dhe publikut për qasje më të lehtë për marrjen e informatave të nevojshme si në faqen zyrtare të KGJK-së, ashtu edhe në rrjetin social, Facebook.

KGJK Facebook


Ndjekës në total: 12,805



Janë publikuar gjithsejtë, treqind e njëzet e shtatë (327) komunikata dhe njoftime. Në faqen zyrtare në Facebook, janë publikuar gjithsejtë, treqind e dyzet e shtatë (347) publikime.

Më poshtë, gjeni të dhëna demografike që bazohen në moshën dhe gjininë që ndjekësit e faqes ofrojnë në profilet e tyre si dhe top tre (3) lokacionet nga të cilat vijnë:

Gjinia femërore: 46.7%
Gjinia mashkullore: 53.3%



KGJK ka miratuar Strategjinë e Komunikimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022 – 2024 si dhe Planin e Veprimit të kësaj strategjie. Implementimi i Strategjisë rezultoi në rritje të transparencës së punës së gjyqësorit, duke ndikuar rritjen e bashkëpunimit me partnerët tanë në fushën e medias dhe shoqërisë civile.

KGJK ka publikuar video shpjeguese dhe materiale udhëzuese, grafika dhe raporte të ndryshme, të cilat ndërlidhen me mesazhe për qytetarët për marrjen e informacioneve dhe shërbimeve brenda sistemit gjyqësor.

Brenda afateve ligjore, Zyra ka trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike nga OJQ-të që punojnë dhe veprojnë në Kosovë, të cilat monitorojnë punën e sistemit gjyqësor. KGJK ka vazhduar bashkëpunimin e këto OJQ: IKD, GLPS, Lëvizja Fol, BIRN, KDI, AVONET, YIHR-KS, INJECT, etj.

Zyra për Komunikim e KGJK-së ka ndjekur trajnime në fushën e komunikimit si dhe ka qenë pjesë e vizitës studimore në Hagë për të mësuar më shumë rreth strategjive të komunikimit dhe programeve sensibilizuese të institucioneve të ndryshme në Holandë.

8.14 Certifikuesi

Certifikuesi është përgjegjës për realizimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Deri në fund të vitit raportues, janë pranuar gjithsejtë 2,083 lëndë për aprovim, në vlerë prej 3,229,718.93€, të kategorive të ndryshme ekonomike, si: shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, mallra dhe shërbime si dhe shpenzime kapitale.

PJESA E PESTË

9. PANELI PËR LIRIMI ME KUSHT

Paneli për Lirim me Kusht (PLK), është kompetent për shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe propozimeve për lirim me kusht, në bazë të raporteve të përpiluara nga ekipet profesionale të institucioneve korrektuese të Kosovës.

Paneli ka mbajtur gjithsej pesëdhjetë e tri (53) seanca brenda afateve ligjore të shqyrtimit të kërkesave. Janë mbajtur seanca të rregullta mujore ku janë shqyrtuar nga pesëmbëdhjetë (15) kërkesa në çdo seancë.

Këtë vit, PLK ka filluar me publikimin e vendimeve të Panelit.

Paneli ka vazhduar bashkëpunimin me Institucionin e Avokatit të Popullit, Misionin e EULEX-it dhe OJQ-të, të cilat kanë monitoruar proceset e liritimit me kusht.

Paneli ka pranuar:

- 905 kërkesa, prej tyre:
 - 804 janë pranuar nga Institucionet Korrektuese në vitin 2022 dhe
 - 101 janë bartur nga viti 2021.

Në total, Paneli ka shqyrtuar 795 kërkesa për lirim me kusht për të cilat është vendosur në këto mënyra:

- Treqind e dymbëdhjetë (312) janë aprovuar;
- Katërqind e tridhjetë e dy (432) janë refuzuar;
- Dyzet e shtatë (47) janë pushuar procedurat e shqyrtimit për lirim me kusht, për arsye të liritimit të parakohshëm nga gjykatat dhe
- Katër (4) janë hudhur poshtë.

Ndërsa, për vitin 2023 janë bartur për shqyrtim njëqind e dhjetë (110) kërkesa.

Numri i kërkesave të shqyrtuara sipas gjinisë është:

- Shtatë qind e tetëdhjetë e tri (783) kërkesa nga gjinia mashkullore dhe
- Dymbëdhjetë (12) kërkesa nga gjinia femërore.

10. NJËSIA PËR INSPEKTIM GJYQËSOR

Njësia për Inspektim Gjyqësor (NJIGJ) është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe administrative për Këshillin dhe komisionet përkatëse të tij, në vlerësimin e punës së gjykatave.

NJIGJ ka realizuar këto aktivitete të punës:

- Ka vazhduar bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore e Arkivave të Kosovës rreth zbatimit të Listës me shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre;
- Ka monitoruar gjykatat rreth procesit të regjistrimit të lëndëve gjyqësore;
- Ka mbajtur takime të rregullta me administratorët e gjykatave lidhur me arkivat e gjykatave;
- Hulumtimi në gjykata lidhur me “Artefakte gjyqësore”;
- Është angazhuar në sistematizimin e logjistik për lirimin e hapësirave në objektin e Gjykatës Themelore në Prizren;
- Bashkëpunimi për arkivimin e lëndëve të noterëve në gjykata;
- Ka mbështetur KVPJGJ-në lidhur me seancat plenare dhe
- Ka mbështetur KAGJ në hartimin e draft Planit Strategjik të KGJK-së për çështje të lëndës arkivore 2023-2025.

Ka mbështetur KAGJ-in në hartimin e memorandumeve shpjeguese si në vijim:

- Memorandum shpjegues për Auditim në Gjykatën Themelore të Prishtinës lidhur me shpërndarjen e lëndëve në divizionin Civil;
- Memorandum shpjegues për themelimin e Grupit Punues për hartimin e draft-Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore;
- Memorandum shpjegues për themelimin e Grupit Punues për hartimin e draft-Udhëzimit Administrativ për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike;
- Memorandum shpjegues për themelimin e Grupit Punues për hartimin e draft-Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e Procedurës së Kompensimit të Dëmit për Personat e Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye;
- Memorandum shpjegues për themelimin e Grupit Punues për hartimin e draft-Udhëzimit Administrativ për Standardizimin e Formave të Vendimeve Procedurale; Memorandum shpjegues për Plotësim Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore;
- Memorandum shpjegues për përcaktimin e Vulës Unike Zyrtare për Certifikatat e gjendjes penale me bazë në SQEPK dhe
- Memorandum shpjegues për nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për Përgjegjësitë, Kompetencën dhe Procedurën Disiplinore në Administratën Gjyqësore.

Njësia ka ofruar mbështetje për KVPJGJ-në lidhur me përgatitjen e njëqind e njëmbëdhjetë (111) dosjeve për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, sipas grupeve:

- Njëzet e katër (24) dosje për gjyqtarët me mandat fillestar;
- Shtatëdhjetë e tetër (78) dosje për gjyqtarët në vlerësim të rregullt dhe
- Nëntë (9) dosje për gjyqtarët në ngritje në detyrë.

11. ZYRA PËR VLERËSIM DHE VERIFIKIM

Zyra për Vlerësim dhe Verifikim është përgjegjëse për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave të nevojshme, të cilat komisionit do t'i shërbejnë për verifikimin dhe vlerësimin e integritetit personal dhe profesional të kandidatit, në procedurën e rekrutimit dhe avancimit.

Për të siguruar dhe verifikuar informatat e duhura lidhur me kandidatët, Zyra ka bashkëpunuar me gjykatat dhe prokuroritë, si dhe: Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Agjencinë Kundër Korrupsion, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Agjencinë për Regjistrimin e bizneseve, Agjencinë Kosovare të Pronës, Administratën Tatimore të Kosovës, Odën e Avokatëve, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Komisionin Qendror Zgjedhor, komunat dhe ministritë e ndryshme, etj.

Zyra ka mbështetur proceset lidhur me konkurset e shpallura nga KGJK, si në vijim:

- Ngritja në detyrë për gjyqtarë në Gjykatën Supreme dhe Dhomën e Posaçme;
- Ngritja në detyrë për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit dhe Divizionin në Mitrovicë;
- Emërimi i kryetarit të Gjykatës së Apelit, Gjykatën Themelore në Prizren dhe Gjykatën Themelore në Gjiilan;
- Emërimi i kryetarit të Gjykatës Komerciale;
- Emërimi i gjyqtarëve mbikëqyrës në degën Zubin Potok, Leposaviq, Novobërdë, Kamenicë dhe Rahovec;
- Rekrutimet në Dhomat e shkallës së parë dhe shkallës së dytë në Gjykatën Komerciale;
- Rekrutimi i gjyqtarëve të rinj;
- Rekrutimi i bashkëpunëtorëve profesional në gjykata;
- Rekrutimi i zëvendës administratorit në Gjykatën e Apelit;
- Rekrutimi për administrator dhe zëvendës administrator në Gjykatën Themelore Prishtinë dhe
- Procesi i rekrutimit për administrator në Gjykatën Komerciale dhe Gjykatën Themelore Prizren.

Zyra ndër të tjera ka mbështetur:

- Komisionin ad-hoc për auditimin e ekzekutimeve të dënimeve gjyqësore në lëminë penale (dënimi me gjobë dhe burgim) dhe në lëminë e kundërvajtje;
- Komisionin disiplinor për administratën gjyqësore;
- Komisionin për certifikimin e ekspertëve gjyqësor;
- Komisionin ad-hoc për auditimin e të dhënave statistikore;
- Komisioni për mbështetje në proceset e rekrutimit të përkthyesve;
- Verifikimi i stafit profesional dhe administrativ të Departamentit Special në kuadër të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore Prishtinë.

12. SFIDAT

Gjatë vitit 2022, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përballur me këto sfida:

- Mos plotësimi i përbërjes së Këshillit nga anëtarët që vijnë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- Shkurtimi i njëqind e gjashtëdhjetë e tetë (168) pozitave të parapara për sistemin gjyqësor që nga vitit 2020;
- Mos aprovimi i pozitave për rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesionalë sipas kërkesave që dalin nga Ligji për Gjykatat, (një gjyqtar një bashkëpunëtor profesional), si dhe stafit tjetër mbështetës për funksionimin e punës së sistemit gjyqësor në përgjithësi;
- Mungesa e buxhetit për praktikantë gjyqësor;
- Mungesa e mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave dhe shtesave, me fokus te veçantë lidhur me zbatimin e Vendimit të Qeverisë, Nr. 04/20 i datës 20.12.2017;
- Ndarja e pamfjaftueshme dhe mungesa e buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për shkak të rritjes së përgjithshme të çmimeve si dhe mos transferimi nga Qeveria i mjeteve nga kategorit tjera;
- Mungesa e hapësirave fizike në disa nga gjykatat e vendit, sa i përket mbajtjes së seancave gjyqësore;
- Menaxhimi jo i duhur i objektit të Pallatit të Drejtësisë nga Institucioni përkatës që merret me menaxhimin e objekteve publike;
- Mbikëqyrja e sigurisë së objektit të Pallatit të Drejtësisë;
- Asgjësimi i regjistrave dhe lëndëve gjyqësore;
- Gjendja e arkivave gjyqësore;
- Dorëzimi i shkresave të gjykatave;
- Evidentimi dhe inventarizimi i pasurisë dhe
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit gjyqësor.



www.gjyqesori-rks.org



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

